

Funded
by the European Union
and the Council of Europe



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Implemented
by the Council of Europe

Projekti kundër krimit ekonomik në Kosovë* (PECK II)

www.coe.int/peck2

Raporti Fillestar

Titulli i projektit	Projekti kundër krimit ekonomik në Kosovë* (PECK II)
Buxheti	2.225.000 Euro: 89,89% nga Bashkimi Evropian dhe 10,11% nga Këshilli i Evropës
Financimi	IPA II 2014: CRIS Nr. 2015/372-097 dhe KiE Nr. JP/ 4561
Zbatimi	Njësinë e Krimit Ekonomik dhe Bashkëpunimit (ECCU) Departamenti për Veprim kundër Krimit Drejtoria e Shoqërisë së Informacionit dhe Veprimit kundër Krimit Drejtoria e Përgjithshme për të Drejtat e Njeriut dhe Sundimin e Ligjit - DG I Këshilli i Evropës
Kohëzgjatja	36 muaj (1 janar 2016 - 31 dhjetor 2018)
Data e raportit	11 prill 2016

* Ky shënim është pa paragjykim të qëndrimeve mbi statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 të KS të OKB-së dhe Opinionin e GJND-së për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.

Ky dokument është realizuar me ndihmën financiare të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës. Pikëpamjet e shprehura këtu në asnjë mënyrë nuk mund të pasqyrojnë mendimin zyrtar të Bashkimit Evropian ose të Këshillit të Evropës.

<p>Për më shumë informacion ju lutemi që të kontaktoni:</p> <p>Njësinë për Bashkëpunimin kundër Krimin Ekonomik (ECCU) Departamenti për Veprim kundër Krimin Drejtoria e Shoqërisë së Informacionit dhe Veprimit kundër Krimin DG I - Drejtoria e Përgjithshme për të Drejtat e Njeriut dhe Sundimin e Ligjit Këshilli i Evropës, F- 67075 Strasbourg Cedex</p> <p>Tel: +33 (0)3 90 21 42 14; Fax: +33 (0)3 88 41 27 05 Email: Maia.MAMULASHVILI@coe.int www.coe.int/corruption</p>	<p>Zyra e Këshillit të Evropës në Prishtinë Rr. Bedri Pejani nr. -18 10000 Prishtinë, Kosovë</p> <p>Tel: +381 (38) 243 749 lok. 106 Fax: +381 (38) 243 752 Email: Edmond.DUNGA@coe.int www.coe.int/peck2</p>
---	---

Përmbajtja

1	INFORMATA TË PËRGJITHSHME.....	5
1.1	FUSHA DHE INSTITUCIONET PËRFITUESE	5
1.2	AUTORITETI KONTRAKTUES	5
1.3	ORGANIZATA ZBATUESE	6
2	PROJEKTI.....	6
2.1	OBJEKTIVI I PËRGJITHSHËM	6
2.2	QËLLIMI I PROJEKTIT	6
2.3	REZULTATET E PRITURA (RP)	6
3	SITUATA NË KOSOVË.....	7
3.1	STANDARDI I PËRGJITHSHËM BAZË I SEKTORIT	7
3.2	POLITIKAT RREGULLATORE, INSTITUCIONALE DHE SEKTORIALE KUNDËR KORRUPSIONIT	11
3.3	POLITIKAT RREGULLATORE, INSTITUCIONALE DHE SEKTORIALE KUNDËR PASTRIMIT TË PARAVE DHE LUFTËS KUNDËR FINANCIMIT TË TERRORIZMIT (LPP/LFT)	16
3.4	ARSYETIMI I PECK II	19
4	ASISTENCË TJETËR TEKNIKE RELEVANTE NDËRKOMBËTARE.....	24
5	PËRMBLEDHJE E REZULTATEVE/QËLLIMEVE TË PROJEKTIT.....	25
5.1	AKTIVITETE	25
5.2	INPUTET	30
5.3	TË ARRITSHMET	30
6	AKTIVITETET FILLESTARE.....	32
6.1	PËRMBLEDHJE E VEPRIMEVE	32
6.2	NGRITJA E EKIPIT TË PROJEKTIT/REKRUTIMI	33
6.3	ZYRA/LOKALET E PROJEKTIT	33
6.4	AKTIVITETET E FILLIMIT - (JANAR - MARS 2016)	33
6.5	KËSHILLI DREJTUES DHE KOORDINATORËT E PROJEKTIT	34
6.6	LANSIMI I PROJEKTIT	35
7	VIZIBILITETI/MBULIMI MEDIATIK.....	36
7.1	FAQJA E INTERNETIT E KiE DHE PECK II	36
7.2	DUKSHMËRIA E BE-SË	36
7.3	PËRJASHTIMI NGA PËRGJEGJËSIA	36
7.4	PUBLIKIME	36
8	BUXHETI DHE KONTRIBUTET.....	37
9	HAPAT E ARDHSHËM DHE KONKLuzionET.....	37
9.1	HAPAT E ARDHSHËM	37
9.2	NDIKIMI MË AFATGJATË	37
10	LISTA E SHTOJCAVE.....	38

Shkurtesa

AAPSK	Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara
AKK	Agjencia Kosovare Kundër Korrupsionit
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
AZL-të	Agjencitë e zbatimit të ligjit
BE	Bashkimi Evropian
BQK	Banka Qendrore e Kosovës
CETS	Seria e Traktateve të Këshillit të Evropës
DK	Doganat e Kosovës
ECCU	Njësia për Bashkëpunimin kundër Krimit Ekonomik, DGI, Këshilli i Evropës
ETS	Seria e traktateve evropiane
EULEX	Misioni Evropian për Sundimin e Ligjit - Kosovë
EUOK	Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë
FATF	Task Forca për Veprim Financiar
GRECO	Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit, Këshilli i Evropës
IPK	Inspektorati Policor i Kosovës
KASH	Konsulencë afatshkurtër
KE	Komisioni Evropian
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KiE	Këshilli i Evropës
KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
LKK	Lufta kundër Korrupsionit
LPP/LFT	Luftimi i Pastrimit të Parave/Luftimi i Financimit të Terrorizmit
MAP	Ministria e Administratës Publike
MD	Ministria e Drejtësisë
MF	Ministria e Financave
MM	Memorandum i Mirëkuptimit
MONEYVAL	Komisioni i Ekspertëve të Këshillit të Evropës për Vlerësimin e Masave kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
NJIF	Njësia e Inteligjencës Financiare
OJQ	Organizatë Joqeveritare
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PECK II	Projekti i përbashkët i BE/KiE kundër Krimit Ekonomik në Kosovë - Faza II
PK	Policia e Kosovës
PSO	Procedura Standarde të Operimit
PSRK	Prokuroria Speciale e Kosovës
PVKK	Plani i veprimit kundër korrupsionit
SKK	Strategjia kundër korrupsionit
TR	Termet e Referencës
ZKM	Zyra e Kryeministrit
ZPSH	Zyra e Prokurorit të Shtetit

1 INFORMATA TË PËRGJITHSHME

Projekti kundër Krimin Ekonomik në Kosovë - (PECK II) filloi më 1 janar 2016. Ky raport fillestar paraqet aktivitetet dhe gjendjen e mjedisit të projektit gjatë kësaj faze si një fazë e përgatitjeve për fillimin e zbatimit të aktiviteteve të projektit. Faza fillestare zyrtarisht ka përfunduar më 31 mars 2016.

1.1 Fusha dhe institucionet përfituese

Përfituesi: Kosova

Institucionet përfituese kryesore: Agjencia Kosovare Kundër Korrupsionit (AKK) dhe Njësia e Inteligjencës Financiare (FIU).

Përfituesit e tjerë të projektit përfshijnë (pa kufizim) agjencitë kyçe në vijim, të cilat luajnë rol në luftën kundër korrupsionit, kundër pastrimit të parave dhe kundër financimit të terrorizmit në Kosovë:

- Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK);
- Banka Qendrore e Kosovës (BQK);
- Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ);
- Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP);
- Kuvendi i Kosovës (KK);
- Doganat e Kosovës (DK);
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK);
- Instituti Gjyqësor i Kosovës (IGJK);
- Policia e Kosovës (PK);
- Inspektorati Policor i Kosovës (IPK);
- Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK);
- Ministria e Integritimit Evropian (MIE);
- Ministria e Financave (MF);
- Ministria e Punëve të Brendshme (MPB);
- Ministria e Drejtësisë (MD);
- Ministria e Administratës Publike (MAP);
- Koordinatori Kombëtar për Luftimin kundër Krimeve Ekonomike (KKLKE);
- Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejtat e Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Çështjet Gjinore / Zyra e Kryeministrit (ZQM);
- Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP);
- Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP);
- Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP);
- Prokuroria Speciale e Kosovës (PSRK);
- Administrata Tatimore e Kosovës (ATK).

Përfitues të tjerë janë sektori financiar dhe industria (subjektet raportuese të LPP/LFT), shoqëria civile dhe gazetarët.

1.2 Autoriteti kontraktues

Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë

Menaxhim indirekt nëpërmjet Marrëveshjes së Delegimit nga BE-ja në bazë të Kornizës së Programit të Përbashkët BE/KiE

1.3 Organizata zbatuese

Këshilli i Evropës është bashkëthemelues dhe përgjegjës për zbatimin e projektit dhe përdorimin e fondeve të projektit në kuadër të marrëveshjes së Komunitetit Evropian me zyrën e Bashkimit Evropian në Kosovë. Në kuadër të Sekretariatit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës në Strasburg, Drejtoria e Përgjithshme për të Drejtat e Njeriut dhe Sundimin e Ligjit, Drejtoria e Shoqërisë së Informacionit dhe Veprimit kundër Krimin, dhe më saktësisht Departamenti i Veprimit kundër të Krimin, Njësia për Bashkëpunimin kundër Krimin Ekonomik do të jetë struktura përgjegjëse për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e projektit. Ekipi i projektit i vendosur në Prishtinë dhe i mbështetur nga Njësia për Bashkëpunimin kundër Krimin Ekonomik në selinë e Këshillit të Evropës, do të jetë përgjegjës për zbatimin e përditshëm të projektit.

2 PROJEKTI

2.1 Objektivi i përgjithshëm

Objektivi i përgjithshëm i PECK II është të kontribuojë për demokracinë dhe shtetin e së drejtës nëpërmjet parandalimit dhe kontrollit të korrupsionit, pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në Kosovë.

2.2 Qëllimi i projektit

Të forcohen kapacitetet institucionale për të luftuar korrupsionin, pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit në Kosovë në përputhje me standardet evropiane përmes asistencës teknike të fokusuar dhe vlerësimeve për përmirësimin dhe modernizimin e reformave kundër krimin ekonomik.

2.3 Rezultatet e pritura (RP)

Më poshtë janë rezultatet e pritshme të këtij projekti. Arritja e tyre, do të çojë në arritjen e qëllimit të projektit dhe do të kontribuojë në objektivat e përgjithshme:

RP 1 Kapacitetet institucionale të aktorëve të përfshirë në luftën kundër korrupsionit për të zbatuar dhe koordinuar në mënyrë efektive masat kundër korrupsionit janë forcuar më tej;

RP 2 Mekanizmat e shkëmbimit të informacionit dhe bashkëpunimit mes agjencive janë strukturuar për të siguruar masa efektive të koordinuara kundër krimin ekonomik;

RP 3 Raporti i vlerësimit të masave kundër korrupsionit është në dispozicion;

RP 4 Raporti i vlerësimit të masave kundër pastrimit të parave dhe luftës kundër financimit të terrorizmit është në dispozicion.

3 SITUATA NË KOSOVË

3.1 Standardi i përgjithshëm bazë i sektorit

Korrupsioni

Korrupsioni mbetet një sfidë serioze për Kosovën. Ai ndikon në të gjithë sektorët e shoqërisë dhe zhvillohet në të gjitha nivelet. Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit 2014 i Transparency International e vlerëson Kosovën me 33 (100 përfaqëson nivelin më të ulët të korrupsionit), shkalla më e ulët në Ballkan.¹

Sipas treguesve botërorë të qeverisjes të Bankës Botërore², kontrolli i korrupsionit në Kosovë ka treguar pak përmirësim që nga viti 2004, dhe mbetet afër 30% në vitin 2014, i cili është niveli i vitit 2006 (100% përfaqëson kontrollin e plotë të korrupsionit).

Edhe klasifikimi i shteteve në tranzicion sipas korrupsionit nga Freedom House tregon se nuk ka përmirësim gjatë 10 viteve të fundit (klasifikimi i vitit 2015 vazhdon të mbetet më i ulëti në Ballkanin Perëndimor).³

Autoritetet e Kosovës janë të vetëdijshme për sfidat e ndryshme në luftën kundër korrupsionit dhe kërkit të organizuar⁴ që kërkojnë veprime të mëtejshme, të tilla si qasja joefektive me shumë mekanizma në luftën kundër korrupsionit, zbatimi i pamjaftueshëm i ligjit, mungesa e ekspertizës dhe njohurive të mjaftueshme në institucione të ndryshme që luftojnë korrupsionin dhe krimin e organizuar, koordinimi e bashkëpunimi i papërshtatshëm dhe i pamjaftueshëm ndërmjet institucioneve të ndryshme, struktura institucionale të mbivendosura dhe komplekse, kapacitetet dhe burimet e dobëta, të dhënat e paqëndrueshme administrative kundër korrupsionit.

Raporti 2015 i KE për Kosovën i bën jehonë gjetjeve dhe rekomandimeve të Projektit PECK I⁵:

“Kosova është në një fazë të hershme në luftën kundër korrupsionit. [...] Progresi i përgjithshëm ka qenë i kufizuar dhe kërkohet vullnet i fortë politik dhe angazhim i nevojshëm për ta trajtuar këtë fenomen si duhet. [...] Ka një shikim të përgjithshëm dhe mungesë të integritetit ndërmjet organeve kryesore kundër korrupsionit në Kosovë, të cilat vuajnë nga mbivendosja e mandateve dhe një ndarje e paqartë e detyrave.”

¹ <http://www.transparency.org/cpi2014/results> Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit i vitit 2013 është i ngjashëm, ndërsa në vitin 2012 ka qenë 34.

² Banka Botërore, Treguesit botërorë të Qeverisjes, Kontrolli i korrupsionit <http://info.worldbank.org/governance/wgi/>

Me gjithë përmirësimin në vitin 2014, klasifikimi mbetet kryesisht nën mesataren e Ballkanit Perëndimor dhe një nga nivelet më të ulëta.

³ Vlerësimet në kuadër të shteteve në tranzicion janë të bazuara në një shkallë nga 1 deri në 7, ku 1 përfaqëson nivelin më të lartë dhe 7 nivelin më të ulët të kontrollit të korrupsionit. Kosova renditet në shkallën 6 nga viti 2004 deri në vitin 2007, në shkallën 5.75 nga viti 2008 deri në vitin 2012 dhe përsëri në shkallën 6 nga viti 2013 deri në vitin 2015: <http://www.freedomhouse.org>

⁴ Raporti diagnostikues: Kosova në rrugën e saj drejt Bashkimit Evropian (një analizë mbështetëse për një strategji kombëtare për integrimin evropian) http://www.president-ksgov.net/repository/docs/Diagnostic_Report_ENG.pdf

Shih edhe Strategjinë e Kosovës për Integrim Evropian 2014-2020: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/National_Strategy_for_European_Integration_Kosovo_2020_ENG.PDF

⁵ http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2015/20151110_report_kosovo.pdf (shih faqet 15 deri në 17 dhe 58).

Raporti u kushton vëmendje të veçantë aspekteve të mëposhtme: nevojës së historikut të hetimeve, ndjekjeve penale dhe dënimeve në rastet e korrupsionit, prioritetit në trajtimin e rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë, forcimit të bashkëpunimit mes institucioneve relevante, monitorimit të historikut të trajtimit të rastit, rishikimit të ligjit të konfliktit të interesit dhe të gjitha ligjeve dhe rregulloreve të lidhura për t'i harmonizuar me standardet evropiane, rregullimit të "dyerve rrotulluese", nevojës për të kryer hetime efektive financiare, konfiskimit efektiv të aseteve kriminale, zbatimit të duhur të dhënies së alarmit (sinjalizimit të akteve të korrupsionit), hetimit të pasurisë së pashpjegueshme, përmirësimit të konsultimit të shoqërisë civile përmes komunikimit të rregullt, transparent dhe konstruktiv, forcimit të mëtejshëm të task forcës kundër korrupsionit, zbatimit të duhur të strategjisë kundër korrupsionit dhe planit të veprimit me anë të treguesve të matshëm të ndikimit.

Kosova po vazhdon të sjellë rezultate të dobëta në luftën kundër korrupsionit, sidomos në rastet e profilit të lartë. Me përfshirjen e palëve të interesuara, Këshilli Prokurorial i Kosovës ka zhvilluar një mekanizëm të gjurmimit të rasteve të veprave penale dhe ka publikuar raportin e parë vjetor në vitin 2013, duke përfshirë edhe rastet e korrupsionit. Raportet e mëvonshme dyvjeçare dhe vjetore përfshinë edhe krimet ekonomike. Megjithatë, historiku i dënimeve të lidhura me korrupsionin duhet të përmirësohet dhe të përditësohet në mënyrë adekuate. Për më tepër, statistikatat në dispozicion japin vetëm shifra të përgjithshme pa ndarjet e dhura dhe informacion mbi tipologjinë e veprave dhe nivelet ose kategoritë e të pandehurve (në veçanti në rastet e zyrtarëve publikë).

Këshilli Gjyqësor dhe ai Prokurorial ndërmorën masa kohët e fundit për t'i dhënë prioritet rasteve të korrupsionit. Udhëzimi i Përbashkët Administrativ i 13 nëntorit 2013 që ishte bashkë-nënshkruar nga kryeprokurori i Shtetit, kryeprokurori i EULEX-it dhe shefi i PSRK-së ka përcaktuar veprën "në nivel të lartë të korrupsionit". Megjithatë, ndërsa qarkullimi i rasteve të korrupsionit është duke treguar një tendencë në rritje në nivelet e policisë dhe prokurorisë, rezultatet janë ende të kufizuara dhe vetëm disa raste të korrupsionit janë regjistruar në fazën gjyqësore. Për më tepër, dominojnë të pandehur me profile mjaft të ulëta ose mesatare si dhe dënime jo-parandaluese (kryesisht më pak se një vit burgim, dënime me kusht, gjobat, etj.)

Hetimi dhe gjykimi i veprave penale të korrupsionit në Kosovë në vitin 2014 ⁶	Të dyshuar të raportuar	Hetime	Raportet penale të hedhura poshtë	Hetime të mbyllura	Aktakuza	Në procedurë	Aktakuza të hedhura poshtë	Dënime	Të tjera (provë, lirim, etj.)
Agjencia kundër Korrupsionit	186	-	-	-	-	-	-	-	-
Policia	449	-	-	-	-	-	-	-	-
Të tjera	376	-	-	-	-	-	-	-	-
Prokurorët	+1.558	1.016	248	297	471	1.558	-	-	-
Gjykatat ⁷	307	-	-	-	-	-	40	132	135

Hetimi dhe gjykimi i veprave penale të korrupsionit në Kosovë në gjysmën e parë të vitit 2015 ⁸	Të dyshuar të raportuar	Hetime	Raportet penale të hedhura poshtë	Hetime të mbyllura	Aktakuza	Në procedurë	Aktakuza të hedhura poshtë	Dënime	Të tjera (provë, lirim, etj.)
Agjencia kundër Korrupsionit	15	-	-	-	-	-	-	-	-
Policia	197	-	-	-	-	-	-	-	-
Të tjera	188	-	-	-	-	-	-	-	-
Prokurorët	+1.607	301	57	59	185	1.706	-	-	-
Gjykatat ⁹	141	-	-	-	-	-	21	65	55

Përdorimi i masave të fshehta nga prokurorët për të hetuar rastet e korrupsionit është rritur ndjeshëm gjatë viteve të fundit. Numri i masave të tilla ishte 96 në vitin 2013, 118 në vitin 2014 dhe numri i tyre

⁶ Shifrat i referohen personave. Këshilli Prokurorial i Kosovës Raporti Vjetor 2014 mbi harmonizimin e Statistikave nën Mekanizmin Ndërinstitucional për Harmonizimin e Statistikave të veprave penale karakteristike, 2015, <http://www.psh-ks.net/>

⁷ Këto janë të dhëna nga burime të KGJK-së (shih gjithashtu "Pandëshkueshmëria në Kosovë: Lufta kundër korrupsionit me profil të lartë", KIPRED, 2016, fq. 24). Të dhënat e KPK-së nuk përputhen (nga 103 persona, për 5 është hedhur poshtë aktakuza, 67 janë të dënuar dhe 31 morën vendime të tjera).

⁸ Shifrat u referohen personave. Këshilli Prokurorial i Kosovës Raporti Dyvjeçar (janar qershor 2015) mbi harmonizimin e Statistikave nën Mekanizmin Ndërinstitucional për Harmonizimin e Statistikave të veprave penale karakteristike, 2015, <http://www.psh-ks.net/>

⁹ Të dhënat e KPK-së nuk përputhen (nga 66 persona, për 4 është hedhur poshtë aktakuza, 44 janë të dënuar dhe 18 morën vendime të tjera).

arriti në 123 masa të fshehta gjatë gjysmës së parë të vitit 2015. Në tetor 2015, Kryeprokurori i Shtetit ka lëshuar udhëzimin nr. 442/2015 mbi zbatimin e nenit 96 të KPP-së në lidhje me masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit.

Megjithatë, numri i rasteve të pezulluara dhe hetimeve të mbyllura vazhdon të jetë i rëndësishëm dhe në përgjithësi më i lartë se numri i aktakuzave. Nga 1.016 kallëzime penale në vitin 2014, kallëzimet penale janë hedhur poshtë dhe hetimet janë ndërprerë për 545 persona (53.6%), ndërsa paditë janë ngritur kundër 471 personave (46.4%). Gjatë gjysmës së parë të vitit 2015, u ngritën 185 aktakuza (61.5%), kundrejt 116 kallëzimeve penale të pushuara dhe hetimeve të mbyllura (38.5%).

Agjencitë e zbatimit të ligjit hezitojnë t'i nisin hetimet financiare dhe numri i rasteve të ngrirjes dhe konfiskimit të pasurive të urdhëruara nga gjyqësori dhe të ekzekutuara nga policia vazhdon të mbetet i ulët. Në veçanti, konfiskimi i aseteve të përfituara nga korrupsioni i profilit të lartë është pothuajse jo-ekzistent¹⁰. Në shumicën e hetimeve dhe aktakuzave të rasteve të lidhura me korrupsion nuk ka asnjë kërkesë për të sekuestruar dhe të konfiskuar fitimet e paligjshme. Më 14 janar 2014, Kryeprokurori i Shtetit ka lëshuar Udhëzimin Administrativ Nr. 04/2014 mbi veprimet e prokurorëve në lidhje me asetet e sekuestruara dhe konfiskuara përkohësisht, ose me pronën për të cilën është lëshuar një Urdhër i ngrirjes.

Njëri nga rekomandimet e rëndësishme të Raportit të Vlerësimit kundër korrupsionit të PECK I ishte i lidhur me nevojën për të zgjeruar statutin e kufizimit për hetimin që është mjaft i shkurtër dhe i pamjaftueshëm për raste të mëdha dhe komplekse të korrupsionit (aktualisht vetëm 2 vjet). Ende nuk janë marrë hapa për ta adresuar këtë çështje, teksa praktika mjaft e zakonshme e mos ngritjes së aktakuzës brenda afatit të hetimit po pengon disa raste të profilit të lartë dhe i ndalon prokurorët që të merren me raste të ndërlikuara¹¹.

Edhe pse institucionet e ndryshme pretendojnë për nivel të mirë të bashkëpunimit ndërinstitucional dhe pavarësisht përmirësimeve në lidhje me këtë, niveli i bashkëpunimit mes institucioneve të ndryshme mbetet i dobët dhe i paqëndrueshëm. Ka një kapacitet të dobët të zbatimit. Përpjekjet kundër korrupsionit vuajnë nga mungesa e veprimit të bashkërenduar dhe me forcë si dhe përcjellja me masa ndëshkuese.

Pastrimi i Parave/Financimi i Terrorizmit

Projekti i përbashkët i Bashkimit Evropian/Këshillit të Evropës kundër Krimit Ekonomik në Kosovë (PECK) ka prodhuar në dy cikle të njëpasnjëshme raportet e vlerësimit "të pajtueshmërisë së Kosovës me standardet evropiane dhe ndërkombëtare të fushave kundër pastrimit të parave dhe luftës kundër financimit të terrorizmit (LPP/LFT). Të miratuar në qershor të vitit 2013 dhe dhjetorit të vitit 2014, raportet e vlerësimit LPP/LFT përbëjnë vlerësimin e parë të plotë të Kosovës në bazë të rekomandimeve të FATF 2003 dhe Rekomandimeve të veçanta mbi financimin e terrorizmit të vitit 2001 të task-forcës për veprime financiare (FATF), dhe janë përgatitur duke përdorur Metodologjinë e vlerësimit LPP/LFT 2004 të FATF/MONEYVAL¹².

Ka pak njohuri të përbashkët, informacione të njohura ose të dhëna statistikore në dispozicion të publikut mbi fenomenin PP dhe FT në Kosovë, pavarësisht Vlerësimit të Rrezikut Kombëtar (VRrK) të ndërmarrë nga autoritetet e Kosovës gjatë vitit 2013. Nuk ka të dhëna statistikore në dispozicion të publikut në Kosovë në lidhje me madhësinë dhe shkallën e kërcënimit. Teksa Njësia e Inteligjencës Financiare (NJIF) prodhon raporte vjetore të aktivitetit, të cilat prej vitit 2011 publikohen në faqen e

¹⁰ Shih referencën në fusnotën 6 më sipër, faqe 20.

¹¹ Shih Raportin Vjetor të AKK-së 2014, faqe 14; shih gjithashtu "[Mosndëshkimi në Kosovë: Lufta kundër korrupsionit me profil të lartë](#)", KIPRED, 2016, fq. 14-16).

¹² Raporti i Vlerësimit LPP/LFT 2014 i Ciklit 2 të PECK-ut (në tekstin e mëtejshëm "Raporti i Vlerësimit LPP/LFT i PECK-ut") mbulon gjitha 40 + 9 rekomandimet e FATF: <http://www.coe.int/peck>

internetit të NJIF-it, statistikat mbi hetimin e rasteve të PP-ve raportohen nga viti 2013 nga KPK-ja në kuadër të Mekanizmit Ndërinstitucional për harmonizimin e statistikave të veprave karakteristike penale. Për më tepër, NJIF dhe institucionet e tjera relevante mbajnë statistika minimale për RTD/RTPG të pranuar dhe të shpërndara dhe për informatat kthyesë mbi rezultatin e dërgimit tek zbatimi i ligjit. Megjithatë, sasia dhe cilësia e të dhënave nga autoritetet e zbatimit të ligjit dhe autoritetet gjyqësore vazhdojnë të jenë të pamjaftueshme për të vlerësuar numrin dhe karakteristikat e veprave të lidhura me pastrimin e parave të hetuara, të ndjekura penalisht dhe të përpunuara në gjykata. Edhe pse janë raportuar raste të lidhura me PP të hetuara gjatë viteve të fundit, ka një mungesë ose nivel shumë të ulët të aktakuzave.

Deri më tani dhe deri kohët e fundit (2015), nuk ka pasur një vendim të vetëm gjyqësor të formës së prerë në rastet PP në Kosovë.

Hetimi dhe gjykimi i veprave penale të pastrimit të parave në Kosovë në vitin 2014 ¹³	Të dyshuar të raportuar	Hetime	Raportet penale të hedhura poshtë	Hetime të mbyllura	Aktakuza	Në procedurë	Aktakuza të hedhura poshtë	Dënime	Të tjera (provë, lirim, etj.)
Agjencia kundër Korrupsionit	3	-	-	-	-	-	-	-	-
Policia	14	-	-	-	-	-	-	-	-
Të tjera	8	-	-	-	-	-	-	-	-
Prokurorët	+94	43	5	20	18	76	-	-	-
Gjykatat ¹⁴	-	-	-	-	-	-	-	-	-

Hetimi dhe gjykimi i veprave penale të pastrimit të parave në Kosovë në gjysmën e parë të vitit 2015 ¹⁵	Të dyshuar të raportuar	Hetime	Raportet penale të hedhura poshtë	Hetime të mbyllura	Aktakuza	Në procedurë	Aktakuza të hedhura poshtë	Dënime	Të tjera (provë, lirim, etj.)
Agjencia kundër Korrupsionit	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Policia	7	-	-	-	-	-	-	-	-
Të tjera	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Prokurorët	+85	10	4	2	4	82	-	-	-
Gjykatat ¹⁶	1	-	-	-	-	-	-	1	-

Sa i përket rimëkëmbjes së aseteve, Kosova përballet me vështirësi serioze në demonstrimin e përpjekjeve të vazhdueshme dhe të dhënave në lidhje me sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive dhe të ardhurave të paligjshme.

Sekuestrimi dhe konfiskimi i të ardhurave nga krimi (2014) ¹⁷ :			
Artikuj	Të ardhurat e konfiskuara (Neni 267 KPP)	Konfiskim i kërkuar	Konfiskim i lejuar
Armë	5.002	24	-
Automjete	63	41	5
Shtëpi	4	-	-
Para të gatshme (€)	117.491,60€	21.920,24€	10.930,65€
Para në llogari	-	1.267.115.971,01	-

¹³ Shih fusnotën 5 më lart.

¹⁴ Nuk ka të dhëna për procese gjyqësore.

¹⁵ Shih fusnotën 6 më lart.

¹⁶ Ky është i pari gjykim për pastrim parash në gjykata prej rreth dy vitesh.

¹⁷ Shih fusnotën 5 më lart.

rrjedhëse (€)			
Narkotikë (kg)	61,58	21.309,84	2.950,33
Barna	20.449	10.991	9.152
Mallra me vlerë	98.153	22.301,86	10.700
Vlera e parashikuar (€)	756.105,19€	-	5.980€

Megjithatë, shkalla e pastrimit të parave ka të bëjë me shtrirjen e ekonomisë së zezë informale (droga, prostitucioni, kontrabanda e mallrave ilegale, falsifikimi dhe pirateria dhe aktivitete të tjera kriminale, duke përfshirë, në këtë kontekst, evazionin fiskal, si pjesë e ekonomisë gri). Të dhënat vërtetojnë rëndësinë e ekonomisë së zezë në Kosovë përmes lëvizjeve të tepërta ndër-kufitare hyrëse dhe sidomos dalëse të parasë¹⁸. Sipas një raporti të vitit 2013 të Europolit për "Vlerësimin e Kërcënimit të Krimin të rëndë dhe të organizuar të BE-së" (SOCTA 2013), rajoni i Ballkanit Perëndimor mbetet shumë aktiv për organizatat kriminale, sidomos në fushën e drogës dhe trafikimit të armëve.¹⁹ Të ardhurat nga këto burime penale janë subjekt i aktiviteteve të pastrimit të parave.

Për këtë arsye, nuk befason fakti se për periudhën 2012 - 2014, tek NJIF janë raportuar çdo vit mesatarisht 546.969 transaksione në para të gatshme (mbi 10.000 €), një numër i cili është jashtëzakonisht i lartë në krahasim me madhësinë e popullsisë dhe ekonomisë së Kosovës. Në të njëjtën kohë, NJIF ka marrë edhe disa transaksione të dyshimta në lidhje me financimin e terrorizmit (16 raporte që përfshijnë 56 individë dhe subjekte juridike në 2014).

3.2 Politikat rregullatore, institucionale dhe sektoriale kundër korrupsionit

Në kuadër të procesit të liberalizimit të vizave, më 28 maj 2015 Kuvendi miratoi paketën e ligjeve të drejtësisë, duke përfshirë ndryshimet dhe plotësimet e ligjeve për gjykatat, prokurorin e shtetit, Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillin Prokurorial të Kosovës, të cilat ose janë shkaktuar pjesërisht nga disa rekomandime të raporteve të vlerësimit PECK I, dhe/ose i kanë trajtuar pjesërisht. Sipas të njëjtit proces, në fund të 2015 dhe fillim të vitit 2016 u bënë ndryshimet e Ligjit të Prokurimit Publik (shih listën më poshtë).

Disa ligje janë miratuar së fundmi nga Kuvendi:

- Ligji Nr. 05/L-069 për Ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian dhe Komunitetin Evropian të Energjisë Atomike;
- Ligji Nr. 05/L-063 dhe Ligji Nr. 05/L-007 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin dhe Përgjegjësitë e Financave Publike, të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, nr. 04/L-116 dhe 04/L-194;
- Ligji Nr. 05/L-092 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 të Prokurimit Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237 dhe Ligjin Nr. 05/L-068;
- Ligji Nr. 05/L-094 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-223 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-033 dhe Ligjin Nr. 04/L-115;
- Ligji Nr. 05/L-049 për Menaxhimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar.

Përveç kësaj, projektligjet e mëposhtme janë në procedurë parlamentare:

- projektligji Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit;
- projektligji Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative;
- projektligji Nr. 05/L-087 për Kundërvajtje;

¹⁸ Shih Raportin e Qeverisë për situatën 01/2014 për Parandalimin e Ekonomisë Joformale dhe Krimeve Financiare në Kosovë, faqe 20, Tabela 3. Në vitin 2013, raportet e transaksioneve në para të gatshme ishin 606.778, teksa arrijnë në 553.651 në 2014 (shih për më shumë informacion [Raporti Vjetor 2014 i NJIF](#)).

Në rastin e euros, lëvizjet ndërkufitare dalëse të mjeteve monetare arrijnë në € 645.7 milionë euro në vitin 2013 dhe € 658 milionë në vitin 2014.

¹⁹ <https://www.europol.europa.eu/sites/default/files/publications/socta2013.pdf>

- projektligji për Akademinë e Drejtësisë.

Për më tepër, Programi Legjislativ 2016 i Qeverisë parashikon ligjet dhe ndryshimet e mëposhtme përkatëse²⁰:

- Projektligji për Doganat e Kosovës dhe Inspektoratin e Administratës Tatimore;
- Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-014 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim;
- Projektligji për Agjencinë të ardhurave;
- Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04-L-139 për procedurën përmbarrimore;
- Projektligji për Zyrën e Prokurorit Disiplinor;
- Projektligji për Konfiskimin e Pasurisë së pajustificueshme;
- Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04-L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit²¹;
- Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-223 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-033 dhe Ligjin Nr. 04/L-115;
- Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-224 të Këshillit Prokurorial të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-035;
- Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-123 për organizatat afariste;
- Projektligji për inspektimet;
- Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-149 për shërbimin civil;
- Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-189 për administratën shtetërore;
- Projektligji për pagat e paguara nga buxheti.

Kuadri ligjor, edhe pse relativisht i ri dhe shumë shpesh i ndryshuar dhe plotësuar, ende ka nevojë për riorganizim dhe mbetet i paqartë në fusha të caktuara.

Një ilustrim tipik është Ligji nr. 04/L-140 mbi kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfutur me vepër penale që është përdorur vetëm një herë që nga hyrja në fuqi në mars të vitit 2013. Ligji është konsideruar jofunksional dhe ka mbetur kryesisht i panjohur nga praktikuesit.²²

Të dy raportet e vlerësimit PECK I për LKK dhe LPP/LFT kanë identifikuar nevojat e ndryshme të rëndësishme për të shqyrtuar dhe përvijuar legjislacionin ekzistues me standardet përkatëse evropiane dhe ndërkombëtare. Kjo përfshin *ndër të tjera* harmonizimin dhe përmirësimin e Kodit Penal dhe dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurës Penale, mes këtyre kodeve dhe legjislacionit tjetër LKK dhe LPP/LFT, legjislacioni që mbulon përgjegjësinë e personave juridikë, sekuestrimin dhe konfiskimin e instrumenteve dhe produkteve të korrupsionit, bashkëpunimi ndërkombëtar, parandalimi i konfliktit të interesave, ligjet dhe rregulloret përkatëse për gjyqtarët, prokurorët, oficerët dhe nëpunësit e policisë, dyert rrotulluese dhe mbrojtja e informatorëve, financimi i partive politike dhe fushatave zgjedhore dhe prokurimi publik.

Sa i përket kornizës **institucionale**, **Zyra e Kryeministrit për Qeverisje të Mirë**, të Drejtat e Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Çështje Gjinore (ZQM) po merret ndër të tjera me çështjet e lidhura me qeverisjen e mirë. Megjithatë roli i saj mbetet i kufizuar tek koordinimi, këshillimi dhe mbështetja në të gjithë sektorët e ekzekutivit në konsultim me grupet e ndryshme të interesit dhe në bashkëpunim të

²⁰ Për më tepër, lista e miratuar e koncept dokumenteve (parakushti fillestar i një nisme ligjore) që do të paraqitet në vitin 2016 përfshin *ndër të tjera* fushat e mëposhtme: qasjen në dokumente publike, kontrollin e brendshëm të financave publike, Inspektoratin Policor të Kosovës dhe rregullimin dhe funksionimin e organizatave jo-qeveritare.

²¹ Një projektligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik është dorëzuar dhe ridorëzuar në Kuvend që nga dhjetori 2014, dhe më në fund është tërhequr nga qeveria në dhjetor 2015.

²² Shih [‘Mosndëshkimi në Kosovë: Lufta kundër korrupsionit me profil të lartë’](#), KIPRED, 2016, fq. 5-6.

ngushtë me AKK-në. Në nivelin e qeverisë, nuk ka ndonjë organ ndërmintor/strukturë për përpjekjet e ndaj korrupsionit dhe zbatimin e masave të politikave në të gjithë sektorët.

Megjithatë, një **Këshill kundër Korrupsionit**²³ u krijua që nga shkurti i vitit 2012 me iniciativën dhe nën drejtimin e Presidentit të Kosovës, me qëllim përmirësimin e koordinimit dhe rritjen e ndërgjegjësimit mes të gjitha organeve dhe institucioneve të përfshira në luftën kundër korrupsionit. Përveç ndonjë rezultati pozitiv për të shërbyer si një forum për shkëmbim të informacionit, funksionet e tij janë tepër të përgjithshme për shkak të rolit të tij të konsultimeve dhe për këtë arsye ndikimi i tij duket të jetë i kufizuar.

Agjencia Kosovare Kundër Korrupsionit (AKK) është organi kryesor operativ i politikave kundër korrupsionit dhe i mbikëqyrjes që nga viti 2006. I përbërë nga rreth 40 të punësuar dhe me një buxhet vjetor të dedikuar prej rreth 500.000 euro, AKK-ja ka arritur të rrisë dhe të forcojë disa nga kapacitetet e veta, dhe "është organ i pavarur dhe i specializuar për zbatimin e politikave shtetërore për luftimin dhe parandalimin e korrupsionit në Kosovë"²⁴. Drejtohet nga Drejtori që zgjidhet nga Kuvendi për një mandat 5-vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje një herë.

Sa i përket zbatimit të ligjit dhe prokurorisë, **Prokuroria Speciale e Kosovës (PSRK)** është themeluar në vitin 2006²⁵. Duke qenë një zyrë e përhershme dhe e specializuar prokuroriale që vepron në kuadër të Prokurorisë së Shtetit të Kosovës, PSRK-ja merret me rastet e korrupsionit të nivelit të lartë. Më konkretisht, ajo ka kompetencë ekskluzive për të hetuar dhe ndjekur penalisht *ndër të tjera* pastrimin e parave, veprat penale të terrorizmit, krimin të organizuar (neni 5), si dhe një kompetencë plotësuese për veprat penale të përcaktuara në nenin 9 të Ligjit (veprat penale të trafikimit, falsifikimit të parave, veprat e korrupsionit dhe mashtrimin dhe vepra të tjera të rënda). PSRK është i përbërë nga 9 prokurorë specialë vendas dhe një U.D Kryeprokuror, dhe 5 prokurorë të EULEX-it. Një task forcë kundër korrupsionit e përbërë nga prokurorë specialë dhe 30 hetues të policisë u krijua në vitin 2011 për të hetuar krimet ekonomike dhe financiare. Që nga fillimi i vitit 2016, Kryeprokurori i Shtetit ka ngritur një njësi të re kundër korrupsionit dhe Krimin Ekonomik në kuadër të Departamentit të Krimeve të Rënda të Gjykatës Themelore të Prishtinës. Megjithatë, është e paqartë rreziku i mbivendosjes midis kësaj njësie të re dhe kompetencës ekskluzive të PSRK që të merret me raste të ndërlikuara dhe të ndjeshme të korrupsionit.

Policia e Kosovës²⁶ (PK) ka themeluar në kuadër të Departamentit të Hetimit të Krimeve, Divizionin për Hetimin e Krimeve (DHKEK) i cili merret me hetimin e veprave penale kundër ekonomisë ,detyrës zyrtare dhe hetimit financiar dhe përbëhet nga: Sektori i Hetimeve të Krimeve Ekonomike i ndarë në dy njësi: Njësia për Krime Ekonomike dhe Njësia për Falsifikim të Dokumenteve dhe Parasë, Sektori i Hetimeve të Korrupsionit, Sektori për Hetime Financiare i ndarë në: Njësia për Hetime Financiare, Njësia Kundër Pastrimit të Parasë dhe Njësia për Hetimin e Aseteve, dhe 8 Njësi Rajonale për hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit (Prishtinë, Ferizaj, Gjiilan, Prizren, Gjakovë, Pejë, Mitrovicë e Jugut dhe Mitrovicë e Veriut).

PK-ja mbikëqyret nga **Ministria e Punëve të Brendshme (MPB)**. Në kuadër të MPB-së, **Inspektorati Policor i Kosovës (IPK)** është themeluar në vitin 2006, si organ ekzekutiv. IPK-ja përbëhet nga shefi ekzekutiv, i cili i përgjigjet MPB-së, dhe zyrtarët e hetimit/inspektimit, të cilët janë të pavarur nga Policia e Kosovës. Ata janë të mandatuar për hetimin penal dhe inspektimin e njësive policore,

²³ Dekret Nr. DKKK-001-2012 mbi themelimin e Këshillit Kombëtar Kundër Korrupsionit (Botuar në Gazetën Zyrtare më 16 shkurt 2012), në dispozicion në: <http://gazetazyrtare.rks-gov.net/SearchResults.aspx>
Si rregull, Këshilli mbledhet rregullisht të paktën katër herë në vit. Që nga themelimi, janë organizuar 9 takime (i fundit në shtator 2015).

²⁴ Ligji Nr. 03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit të Kosovës, GZ 65/2010, botuar më 05/02/2010. Kompetencat e saj janë rregulluar fillimisht me Ligjin Nr. 2004/34 mbi zhdukjen e korrupsionit (2005).

²⁵ Urdhëresa Administrative e UNMIK nr. 2006/15 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/15 e shfuqizuar me Ligjin Nr. 03/L-052 për PSRK-në, GZ 27/2008, publikuar në 03/06/2008 - Ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-273. Shih gjithashtu Ligjin Nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit, GZ 83/2010, publikuar në 29/10/2010.

²⁶ PK-ja aktualisht rregullohet me Ligjin Nr. 04/L-076 për Policinë, GZ 4/2012, publikuar në 19/03/2012.

intervistimin e oficerëve të policisë, mbledhjen e të dhënave për realizimin e detyrave, si dhe hetimin e veprave penale dhe shkeljeve disiplinore, duke përfshirë edhe akuzat për korrupsion²⁷. Përveç mbikëqyrjes së PK-së, MPB-ja është përgjegjëse për sigurinë e brendshme në Kosovë në përgjithësi, pra edhe luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Sa i përket parandalimit të korrupsionit në gjyqësor, **Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK)** është themeluar në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2005/52, "Për themelimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës". Këshilli siguron pavarësinë dhe paanësinë e sistemit gjyqësor. Ai është përgjegjës për rekrutimin dhe propozimin e kandidatëve për emërim në pozita gjyqësore. Këshilli është gjithashtu përgjegjës për transferimin e gjyqtarëve dhe procedurat disiplinore²⁸. Një kryesues i ri i KGJK-së u zgjodh dhe mori detyrat e tij kohët e fundit. Në kuadër të KGJK-së, **Zyra e Këshillit Disiplinor** është organi përgjegjës për trajtimin e pretendimeve për korrupsion dhe keqpërdorime në gjyqësor²⁹. Megjithatë, mbikëqyrja e gjyqësorit është e paefektshme dhe hetimi i duhur në këtë fushë duket se mungon. Një organ ekuivalent, **Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK)**, ekziston për prokurorët. KPK-ja është përgjegjës për rekrutimin, propozimin për emërim apo riemërimin e kandidatëve për prokurorë si dhe për rekomandimin e shkarkimit të prokurorëve, vlerësimin, promovimin, transferimin, disiplinimin dhe përcaktimin e politikave, standardeve dhe udhëzimeve për trajnimin e prokurorëve³⁰. Përbërja e re e KPK-së, duke përfshirë kryesuesin, është funksionale që nga fillimi i këtij viti.

Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar (AAPSK) është themeluar në qershor të vitit 2010, si një trup i bashkangjitur Ministrisë së Drejtësisë, pas shpalljes së Ligjit për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar (Ligji Nr. 03/L-141) i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin e ri (Ligji Nr.05/L-049 për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar, i publikuar në gazetën zyrtare më 14 prill 2016). Mandati i AAPSK-së është përcaktuar në ligjin në fjalë ku ndër të tjera ka këto përgjegjësi: administrimi dhe/ose shitja e pasurive të sekuestruara apo të konfiskuara. AAPSK-ja ka 24 anëtarë të personelit dhe përfaqëson një strukturë e cila ka krijuar një përvojë të mirë sa i përket administrimit të pasurive por mund të ketë nevojë për ngritje të mëtejshme të kapaciteteve dhe aftësi të specializuara për të trajtuar dhe për të menaxhuar rastet e pasurive të sekuestruara dhe/ose të konfiskuara dhe për të nxitur bashkëpunimin me institucionet e tjera me rëndësi për punën e tyre. Struktura funksionale dhe organizative e AAPSK-së përcaktohet me Rregulloren përkatëse të Agjencisë, e cila miratohet nga Ministri i Drejtësisë dhe përfshihet si shtyllë e veçantë në Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Ministrinë e Drejtësisë.

Ndihma juridike reciproke ndërkombëtare mbetet problematike për shkak të gjendjes së statusit të Kosovës: Kosova nuk është palë e Konventës Evropiane për Ndhmën e Ndërsjellë në Çështjet Penale (ETS 30). Disa shtete evropiane bashkëpunojnë me Kosovën në baza të posaçme, dhe vetëm mbi baza marrëveshjesh dypalëshe, por disa të tjerë nuk e bëjnë këtë³¹. Jashtë Evropës, bashkëpunimi me zbatimin e ligjit dhe gjyqësorin është i pakët. Mungesa e bashkëpunimit ndërkombëtar nga shtetet e huaja po dëmton ndjekjen penale të krimeve në Kosovë dhe në shtetet e tjera.

Në lidhje me nivelin e politikave, **Strategjia kundër Korrupsionit dhe Plani i Veprimit** për periudhën 2013-2017 duket të jetë dokumenti i përgjithshëm kryesor strategjik dhe monitorimi i

²⁷ Ligji Nr. 03/L-231 për Inspektoratin Policor të Kosovës, GZ 87/2010, botuar më 05/02/2010.

²⁸ Ligji Nr. 03/L-223 për këshillin Gjyqësor të Kosovës, GZ 84/2010, publikuar në 03/06/2008 - Ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L2012 (GZ 25, 07.09.2012).

²⁹ <http://www.gjyqesori-rks.org/>

³⁰ Ligji Nr. 03/L-224 për këshillin Prokurorial të Kosovës, GZ 83/2010, publikuar në 03/06/2008 - Ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L2012 (GZ 25, 07.09.2012).

³¹ Në fushat e ekstradimit, ndihmës juridike të ndërsjellë dhe bashkëpunimit gjyqësor, njohjes dhe/ose ekzekutimit të vendimeve gjyqësore penale ose transferimit të personave të dënuar dhe bashkëpunimit policor të ndërsjellë, Kosova ka nënshkruar ose ratifikuar marrëveshje dypalëshe me Shqipërinë, Austrinë, Belgjikën, Kroacinë, Çekinë, IRJM, Hungarinë, Gjermaninë, Italinë, Malin e Zi, Slloveninë, Zvicrën, Turqinë dhe SHBA. Marrëveshje të ngjashme janë në proces ose priten me disa vende të tjera.

zbatimit të tij i është besuar Agjencisë kundër Korrupsionit³². Institucionet përgjegjëse për zbatimin e masave të PV-së raportojnë tek AKK-ja në baza 6-mujore dhe sa herë që u kërkohet, ndërsa AKK-ja paraqet raportin vjetor në Kuvend. Për herë të parë, autoritetet e Kosovës kanë kontribuar me koordinimin e AAK-së dhe asistencën e Këshillit të Evropës për të ndërmarrë një vlerësim fillestar të rrezikut të korrupsionit në sektorët me prioritet gjatë hartimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit AK (shih Shtojcën I të Strategjisë AK). U shprehën nevojat e brendshme dhe u kërkua asistencë teknike për të rinovuar dhe zgjeruar mjetet e vlerësimit të rrezikut, duke përfshirë ndërmarrjen e vlerësimit të rrezikut sektorial të korrupsionit në fusha të caktuara me interes³³.

Zbatimi i strategjisë kundër korrupsionit 2013-2017 dhe planit të veprimit deri më tani kanë gjeneruar trende mjaft të paefektshme që janë për shkak të përfshirjes së pamjaftueshme të të gjitha palëve të interesit dhe mbështetjes së dobët politike. Për më tepër, strategjia dhe plani i saj i veprimit nuk kanë një buxhet dhe mekanizmat e nevojshme për zbatimin e saj nga institucionet e ndryshme, si dhe monitorimi dhe raportimin dyvjeçar janë kryesisht të pamjaftueshëm.³⁴

Periudha	Zbatuar	Zbatuar pjesërisht ose nuk janë zbatuar	Pa raportim
2013	34,3%	32,7%	33%
2014	46,8%	19,9%	33,3%
2015 (korrik-dhjetor)	60,3%	13,2%	26,5%

Funksioni i mbikëqyrjes së AAK-së në lidhje me zbatimin e strategjisë duhet të forcohet. Në këtë drejtim, nuk ka asnjë informacion publik në dispozicion për rishikimin e Planit të Veprimit Kundër Korrupsionit, pas dy viteve të zbatimit dhe përditësimit të mëvonshëm të masave të tij.

4.390 zyrtarë publikë pritet të bëjë deklarinë e rregullt të aseteve të veta deri në fund të marsit 2016. Në lidhje me dështimin për të deklaruar pasuritë, nga vendimet gjyqësore mbi baza kundërvajtje tashmë të administruara në vitin 2014, 46% janë pezulluar në mënyrë proporcionale për mungesë provash apo arsye të statutit të kufizimit, ndërsa rreth 54% e vendimeve pranuan kundërvajtjet e zyrtarëve përgjegjës publikë.³⁵

Në bazë të nenit 437 të futur kohët e fundit të Kodit Penal (dështimi ose deklarimi i rremë i pasurisë dhe i interesave të tjera), në vitin 2014 AKK-ja ka dorëzuar 101 kallëzime penale për shërbimet e prokurorisë. Statistikat gjyqësore tregojnë 16 dënime ose 15.8% (7 gjoba dhe 9 dënime provë)³⁶.

³² Sipas nenit 5 të Ligjit Nr. 03 / L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit (2010), "në bashkëpunim me Komisionin [Parlamentar], Qeverinë, institucione të tjera dhe organizata joqeveritare [AKK-ja] përgatit strategjinë kundër korrupsionit dhe planin e veprimit [...]"

Strategjia për "Bashkëpunimin Ndërinstitucional në luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar" (2013-2015), u miratua nga AKK-ja. Megjithatë, ende nuk ka tregues për ndonjë nismë të mëtejshme të ngjashme strategjike në këtë drejtim.

³³ Vlerësimet sektoriale të rrezikut të korrupsionit të sektorëve të shëndetësisë, arsimit, gjyqësorit, energjisë, dhe minierave janë botuar në vitin 2015 nën asistencën teknike të UNDP-së.

³⁴ Shih raportet e monitorimit mbi zbatimin e Planit të Veprimit kundër korrupsionit dhe raportet vjetore të AKK-së: [Raporti i parë i monitorimit](#), [raporti i dytë i monitorimit](#), [raporti i tretë i monitorimit](#), [AKK 2013 Raporti Vjetor](#) dhe [Raporti Vjetor për vitin 2014 i AKK](#).

³⁵ Me përjashtim të vendimeve qortuese (30% e vendimeve për kundërvajtje), pjesa tjetër janë gjoba që shkojnë nga 250 € në 700 €.

Në vitin 2013, vendimet për kundërvajtje janë rreth 60%. Gjodat nga 50 € në 1,000 € përbëjnë rreth 80%, ndërsa pjesa tjetër janë vendime qortuese.

³⁶ Në vitin 2015, nga rreth 800 formularë të deklarinë plotësisht të audituara, AKK-ja ka dorëzuar 33 kallëzime penale në bazë të nenit 433 të KP-së. Megjithatë, nuk ka as çështje të gjykuar në vitin 2014 e as kallëzime penale në vitin 2015 në bazë të nenit 424 të Kodit Penal (konflikti i interesave). Në vitin 2015, AKK-ja trajtoi 306 situata të konfliktit të interesit (160 raste të shmangura, 39 raste të pushuara, 49 raste me mendime/këshilla, 3 raste të paraqitura për hetime të mëtejshme, 4 kërkesa për kundërvajtje/shkarkime ndaj zyrtarëve përgjegjës dhe 51 raste në vazhdim.

Përveç kësaj, numri i zyrtarëve publikë që mbajnë pozita të shumta është pak më i lartë në vitin 2015 (1.184 zyrtarë me 2 pozicione, 321 me 3 pozicione, 35 me 4 pozicione, 8 me 5 pozicione dhe 4 me 6 pozicione).

3.3 Politikat rregullatore, institucionale dhe sektoriale kundër pastrimit të parave dhe luftës kundër financimit të terrorizmit (LPP/LFT)

Në lidhje me **legjislacionin** kundër pastrimit të parave dhe luftës kundër financimit të terrorizmit (LPP/LFT), përveç disa ligje të rëndësishme të përmendura më lart (shih seksionin 2.2.1 për luftën kundër korrupsionit), janë edhe ligjet vijuese përkatëse:

- Ligji Nr. 03/L-196 për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, GZ 85/2010, 9 nëntor 2010 - Ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-178 (GZ 5, 8 mars 2013);
- Ligji Nr. 03/L-209 për bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, GZ 77/2010, 16 gusht 2010;
- Ligji Nr. 04/L-080 për lojërat e fatit, GZ 9/2012, 4 maj 2012;
- Ligji Nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare jo Bankare, GZ 11/2012, 11 maj 2012;
- Ligji Nr. 04/L-057 për lirinë e shoqërimit në organizata jo qeveritare, GZ 14/2011, 9 shtator 2011;
- Ligji Nr. 02/L-123 për organizatat afariste, GZ 39/2008, 1 tetor 2008 - Ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-006 (GZ 6/2011, 22 korrik 2011).

MF-ja sponsorizoi hartimin e ligjit LPP/LFT nr. 03/L-196, i cili u miratua në shtator 2010. Megjithatë, ky ligj është kritikuar për të meta nga palët e interesuara, duke e shtyrë Ministrinë të iniciojë ndryshime. Plotësimi ndryshimet e ndryshme të këtij ligji, në fakt janë nisur nga MF pas konsultimeve me palët e interesuara të kryera në shkurt 2013. Siç është vënë në dukje nga praktikuesit por edhe nga Raporti i Vlerësimit LPP/LFT i PECK-ut, disa prej amendamenteve të vitit 2013 kanë krijuar vështirësi shtesë në vend që të ofrojnë zgjidhje adekuate. Sa i përket ligjit bazik, me kërkesë të autoriteteve të Kosovës, Këshilli i Evropës ka ofruar këshilla teknike dhe opinion për draftet e mëparshme të ligjit bazë dhe amendamentet.

Në shumë raste, raporti i fundit i plotë i vlerësimit LPP/LFT i PECK-ut thekson nevojën e qartë për ta shqyrtuar legjislacionin primar dhe sekondar LPP/LFT për të siguruar përputhshmërinë e Kosovës me standardet e ndryshme përkatëse ndërkombëtare. Gjatë vitit 2014, autoritetet e Kosovës ndërmorën procesin e rishikimit të Ligjit LPP/LFT dhe iniciuan përmes NJIF-it një proces konsultimi me palët e interesuara. U përgatit një Draft Koncept Dokument dhe u krijua një Grup Punues në këtë drejtim. Sipas Planit të Punës të Projektit PECK, u shtua një aktivitet i veçantë me qëllim të mbështetjes përmes asistencës teknike dhe këshillimit të procesit të rishikimit të Ligjit për PPP/FT, në mënyrë që të përmbushë standardet përkatëse evropiane dhe ndërkombëtare.

Projekti PECK I organizoi tre punëtori (mes dhjetorit 2014 dhe qershorit 2015) dhe siguroi këshillim ndërkombëtar duke përfshirë një opinion ligjor³⁷ mbi projektligjin PPP/FT me qëllim për të udhëzuar dhe ndihmuar Grupin Punues me hartimin e amendamenteve të ligjit LPP/LFT në përputhje me standardet ndërkombëtare në fuqi. Në shkurt 2016, projektligji i ri LPP/LFT kaloi përmes procesit të konsultimit. Projekti PECK II është i përfshirë aktualisht në ofrimin e asistencës dhe ekspertizës së nevojshme për këtë proces deri në finalizimin e tij.

Për më tepër, autoritetet përgjegjëse planifikojnë futjen gjatë vitit 2016 të projektligjeve të mëposhtme: Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-093 për Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare jo bankare; dhe Projektligji për lojërat e fatit (Koncept dokumenti).

³⁷ Opinioni ligjor mbi projekt-ndryshimet e propozuara në ligjin KPP/KFT u përgatit dhe u diskutua me Grupin Punues. Opinioni analizon përputhjen e projekt-ndryshimeve me standardet e aplikueshme ndërkombëtare dhe rekomandimet për adresimin e mangësive të identifikuar. U plotësua me një version të rishikuar të projekt-ndryshimeve me komente shpjeguese ku është e nevojshme.

Në vitin 2015, NJIF ka lëshuar Udhëzimet Administrative Nr. 02/2015 për parandalimin dhe zbulimin e pastrimit të parave (duke përfshirë treguesit) dhe Nr.03/2015 mbi parandalimin dhe zbulimin e Financimit të Terrorizmit (duke përfshirë treguesit).

Sa i përket **kuadrit institucional, Njësia e Inteligjencës Financiare** (NJIF) është themeluar në fund të vitit 2010 dhe ka trashëguar ndërtesën dhe strukturat paraardhëse të Qendrës së Inteligjencës Financiare (QIF), një organ i themeluar nga UNMIK-u³⁸ dhe më vonë i drejtuar nga EULEX-i për të kryer funksionet e NJIF-it. Nën varësinë e MF-së, ky është institucioni qendror i pavarur i ngarkuar me mbledhjen, pranimin, kërkimin, analizimin dhe shpërndarjen e të dhënave të inteligjencës financiare dhe informacionit për parandalimin e pastrimit të parave (dhe veprave të ngjashme) dhe financimit të terrorizmit. NJIF-i mban një bazë të dhënash të të gjitha raporteve të transaksioneve në para të gatshme (RTPG) dhe raporteve të transaksioneve të dyshimta (RTD) dhe të të gjitha të dhënave dhe informacionit të mbledhur gjatë kryerjes së analizave të këtyre raporteve. Për më tepër, NJIF-i shpërndan të dhëna dhe informacione të inteligjencës për agjencitë e zbatimit të ligjit të Kosovës (Policia, Administrata Tatimore, Doganat, Banka Qendrore, etj.) dhe për NJIF-e të tjera jashtë vendit. Duke qenë i tipit administrativ, NJIF-i nuk kryen hetimet e veta, por u siguron organeve të tjera hetimore inteligjencën/informacionin që do të përdoret për të filluar ose vazhduar me hetimet. Megjithatë, pavarësisht përmirësimeve të fundit, në veçanti me Doganat dhe Policinë, NJIF-i nuk merr informata kthyesë të mjaftueshme dhe sistematike mbi rezultatet e hetimeve dhe shpërndarjet³⁹.

NJIF-i ka lidhur memorandume mirëkuptimi (MM) me vendet fqinje dhe vende të tjera dhe për më tepër ka krijuar kanale të komunikimeve elektronike për të shkëmbyer kërkesa me Shqipërinë dhe Malin e Zi (nëpërmjet kanaleve të koduara të siguruara)⁴⁰. Bashkëpunimi me vendet e tjera - për shkak të situatës së statusit të Kosovës - është i pabarabartë në rastin më të mirë. Deri më sot, disa NJIF-e evropiane nuk i janë përgjigjur as inteligjencës mbi transaksionet e dyshimta të paraqitur nga NJIF-i, as kërkesave për informacion⁴¹. Kjo mungesë e bashkëpunimit ndoshta është duke penguar seriozisht zbatimin e ligjit në Kosovë, si dhe në vendet evropiane. Që nga tetori 2014, NJIF-i nuk e ka më praninë ndërkombëtare të 4 këshilltarëve të EULEX-it të deleguar dhe të një zyrtari nga Doganat e Kosovës. Megjithatë, ky reduktim në burimet njerëzore nuk mund të kompensohet me ndonjë rritje të stafit bazë. NJIF-i vazhdimisht trajnon institucioneve financiare për detyrimet e tyre, por ende nuk ka krijuar kapacitete të mjaftueshme të brendshme për vizita inspektuese në terren të pajtueshmërisë në sektorin jo-bankar, të cilin është caktuar ta mbikëqyrë. Megjithatë, gjatë vitit 2014 NJIF-i kreu për herë të parë 35 inspektime të pajtueshmërisë në subjekte raportuese (27 të plota, 7 me fushëveprim të kufizuar dhe 1 inspektim i posaçëm)⁴².

Banka Qendrore e Kosovës (BQK)⁴³ është mbikëqyrësi i kujdesshëm dhe rregullator i bankave dhe institucioneve financiare në Kosovë, në pajtim me Ligjin për BQK-në dhe Ligjin për bankat. Nuk ka treg të kapitalit në Kosovë. Të gjitha bankat janë kryesisht banka të shërbimeve me pakicë dhe 80% e tyre janë në pronësi të institucioneve të huaja financiare. Siç raportohet, të gjitha bankat kanë zyrtarët e pajtueshmërisë dhe aplikojnë një qasje të bazuar në rrezik kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Kompanitë e sigurimeve nuk kanë zyrtarë të pajtueshmërisë. Tregu i sigurimeve është kryesisht i orientuar në sigurimet motorike (rreth 74% e të gjitha policave të sigurimit janë sigurimet e

³⁸ Rregullorja e UNMIK-ut 2004/2 mbi Pengimin e pastrimit të parave dhe veprat e ngjashme penale.

³⁹ Në fund të vitit 2014, NJIF, shërbimi i Prokurorisë së Shtetit, Policia e Kosovës, Doganat e Kosovës dhe Administrata Tatimore nënshkruan një marrëveshje bashkëpunimi për shkëmbimin e informacionit, vlerësimin e rrezikut dhe koordinim.

⁴⁰ Shqipëria, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Mali i Zi, San Marino, Slovenia, Kroacia, Turqia, Republika Çeke, Finlanda, Polonia, Gana.

⁴¹ Në krahasim me vitet e mëparshme, gjatë 2014-ës pothuajse u dyfishua numri i kërkesave të pranuar nga NJIF-e të huaja dhe të shpërndara tek to. Në vitin 2014, ka edhe një rritje të kërkesave dalëse (25) drejtuar 11 NJIF-eve të huaja.

⁴² Aty u përfshinë banka, institucionet mikro-financiare, kompani të sigurimeve, agjenci të këmbimit valutor, agjenci të transferimit të parave dhe OJQ.

⁴³ Gjithsej janë 107 institucione, duke përfshirë 10 banka, prej të cilave 8 janë me pronësi të huaj, 1 zyrë përfaqësuese e një banke fqinje të huaj, 15 kompani të sigurimeve, 12 ndërmjetësues të sigurimeve, 2 fonde pensionale, 18 institucione mikrofinanciare, 6 institucione financiare jo-bankare, 5 agjenci të transferimit të parave dhe 39 zyra të këmbimit valutor. Pjesëmarrja e 3 bankave më të mëdha në gjithsej asetet (shkalla e përqendrimit) është 64.2% ndërsa pronësia e huaj 89.9%.

makina) me sasi të papërfillshme të parave të transferuara. Sipas BQK-së, rreziqet kryesore të pastrimit të parave duhet të kërkohen në sektorin joformal.

Në përputhje me ndryshimet e vitit 2013 të Ligjit PPP/FT, NJIF-i dhe BQK-ja kanë lidhur një marrëveshje (MM) në vitin 2013 që u shqyrtuar në vitin 2014, me të cilin kësaj të fundit i janë deleguar kompetenca mbikëqyrëse për qëllimet e Ligjit PPP/FT për të gjithë sektorin financiar. Me anë të këtij memorandumi, BQK-ja së bashku me NJIF-in monitoron dhe siguron pajtueshmërinë LPP/LFT të bankave, institucioneve mikrofinanciare, IFJB-ve (duke përfshirë zyrat e këmbimit valutor dhe agjencitë e transferimit të parave), si dhe të sigurimeve, letrave me vlerë, tregjeve dhe operatorëve të fondeve private pensionale dhe aktiviteteve të tjera financiare jobankare. BQK-ja ka hartuar një rregullore të re më gjithëpërfshirëse, me qëllim për ta tërhequr Rregullin X dhe Letrën Këshilluese që pasqyron ligjin e ndryshuar PPP/FT. Kjo rregullore ka për qëllim të jetë e zbatueshme për të gjitha bankat dhe institucionet financiare të autorizuara në bazë të Ligjit për Bankat. Me kërkesë të BQK-së, Këshilli i Evropës tashmë ka ofruar asistencë me anë të një dokumenti të detajuar teknik në lidhje me projekt-rregulloren 16, dy direktivat e tjera administrative dhe sidomos mënyrat si të trajtohen kufizimet ligjore ekzistuese.

Nëpërmjet Divizionit të saj për Parandalimin e Pastrimit të Parave, BQK-ja ka rritur inspektimet e pajtueshmërisë në terren të institucioneve të mbikëqyrura. Në vitin 2014, u kryen 14 inspektimeve në terren në banka, institucione mikrofinanciare dhe institucione financiare jobankare.

Njësisia e hetimit financiar në kuadër të Drejtorisë për Hetimin e Krimit të Organizuar është përgjegjëse vetëm për të ashtuquajturat raste të integruara (raste financiare të lidhura ngushtë me krimin e organizuar), por jo për rastet e pavarura të krimit financiar. **Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit** e Policisë së Kosovës (DHKEK) dhe task forca kundër korrupsionit, të mbikëqyrura nga Zyra e Prokurorisë Speciale (PSRK), merren me të gjitha llojet e krimeve financiare. DHKEK-u trajton rastet e rregullta të krimit financiar dhe pastrimit të parave dhe PSRK-ja fokusohet në profilin e lartë dhe raste të ndërlikuara.

Në bazë të nënshkrimit të një memorandumi mirëkuptimi, më 22 nëntor 2013, mes Këshillit Prokurorial të Kosovës, Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Bankës Qendrore të Kosovës, Agjencisë Kosovare të Inteligjencës dhe Agjencisë Kundër Korrupsionit të Kosovës për vendosjen e parimeve themelore të ngritjes dhe funksionimit të **Koordinatorit Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik (KKLEK)**, KPK-ja ka nxjerrë në dhjetor 2013 Rregulloren nr. 1511/2013 për ngritjen dhe funksionimin e Koordinatorit Kombëtar me qëllim të rritjes së efikasitetit në ndjekjen penale të krimeve, sekuestrimin dhe konfiskimin e përfitimeve materiale që rrjedhin nga krimet. Në janar të vitit 2014, një prokuror u emërua si Koordinator Kombëtar. Objektivi kryesor i KKLEK-së është që të promovojë, të koordinojë, të monitorojë, të vlerësojë dhe të raportojë për aktivitetet e të gjitha institucioneve publike dhe private që kanë të bëjnë me parandalimin, zbulimin, hetimin, ndjekjen dhe gjykimin e krimit që gjeneron përfitime materiale, duke mbrojtur sistemin financiar të Kosovës nga rreziku i pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe evazionit fiskal.

Qeveria ka miratuar në maj të vitit 2014 ndarjet shitesë që janë të zbatueshme për Koordinatorit Kombëtar dhe personelin mbështetës prej 6 punonjësish. Që nga viti 2014, KKLEK ka nxjerrë raporte tremujore (janar-mars, prill-qershor, korrik-shtator dhe tetor-dhjetor), të cilat përfshijnë progresin e arritur, aktivitetet që lidhen me fushën e krimit ekonomik dhe rekomandimet specifike me qëllim të adresimit të vështirësive dhe nevojave të identifikuara.

Në nivelin e **politikave**, strategjia LPP/LFT u miratuar në janar të vitit 2014 duke zëvendësuar strategjinë e mëparshme të vitit 2012⁴⁴. Ajo mbulon parandalimin dhe luftimin e ekonomisë joformale,

⁴⁴ Në shtator të vitit 2012, Qeveria e Kosovës miratoi edhe katër strategji të ngjashme për periudhën 2012-2017, d.m.th. një strategji kundër krimit të organizuar, një strategji kundër drogës, një strategji për luftën kundër terrorizmit dhe një strategji për mbrojtjen e kufijve.

pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare për periudhën 2014-2018. Zbatimi i Strategjisë Kombëtare sigurohet nga Plani i Veprimit i cili përfshin 51 aktivitete të veçanta. Dy raporte situatë dhe një raport final vjetor u elaboruan në vitin 2014. Plani i Veprimit i kësaj strategjie kërkon nga autoritetet përkatëse dhe NJIF-K që të zbatojnë qasjen kombëtare dhe sektoriale të vlerësimit të rrezikut me fokus në sektorët më të rrezikuar dhe degët që lidhen me ekonominë joformale, pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe krimet financiare. Nga fundi i 2014-ës u krye dhe u prodhua si draft një vlerësim sektorial i rrezikut për sektorin e ndërtimit⁴⁵.

Edhe pse në vitin 2013 u krye një vlerësim i rrezikut kombëtar (VRrK), nuk përfshinte vlerësimin e rreziqeve sektoriale, çka do të ndërmerret më vonë sipas autoriteteve kosovare. Sipas Planit të Veprimit për zbatimin e gjetjeve nga veprimi 2.2.2 i VRrK-së, të gjitha institucionet e Kosovës janë të obliguara të ndërmarrin Vlerësimin Sektorial dhe specifikohen qartë cilët sektorë do të vlerësohen në bazë të rreziqeve të identifikuara.

Kosova është anëtare e **Bankës Botërore** dhe **Fondit Monetar Ndërkombëtar** (FMN) prej qershorit të vitit 2009 dhe anëtare e plotë e **Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH)** prej dhjetorit 2012. Në qershor të vitit 2013, Kosova nënshkroi një marrëveshje kornizë me BEI-n. Në nëntor të vitit 2013 u anëtarësua në **Bankën për Zhvillim të Këshillit të Evropës** dhe u ftua në qershor 2014 për t'u bashkuar me **Komisionin e Venecias** si anëtare e plotë. Aplikimi i anëtarësimit në **Egmont Group** të Njësisë të Inteligjencës Financiare me gjithsej 151 anëtarë është dorëzuar në viti 2013 nga NJIF-K dhe është në proces. Kosova nuk është anëtare e Task Forcës së Veprimit Financiar (FATF) ose ndonjë prej organeve rajonale të llojit të FATF-it (p.sh. MONEYVAL).

3.4 Arsyetimi i PECK II

Qëllimi i PECK II është që të vazhdojë forcimin e kapaciteteve institucionale për të luftuar korrupsionin, pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit në Kosovë në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare. Teksa synon që të sigurojë vazhdimësinë e asistencës së mëparshme dhe të shërbejë si vazhdim, Projekti PECK II ofron një grup të rëndësishëm të aktiviteteve të asistencës teknike, si dhe mbulon nevojat për vlerësim të strukturuar të mëtejshëm. PECK II bazohet në rezultatet dhe mësimet e nxjerra nga PECK I dhe synon të mbështesë reformat dhe përpjekjet ndaj krimit ekonomik me theks të veçantë në masat e lidhura me luftën kundër korrupsionit, si dhe që të kontribuojë në forcimin e kapaciteteve dhe qëndrueshmërinë e përpjekjeve kundër krimit ekonomik. Do të asistojë autoritetet e Kosovës në zbatimin e rekomandimeve të caktuara nga ciklet e mëparshme të vlerësimit të kryera në kuadër të PECK I, nëpërmjet asistencës teknike të shënjestruar, si dhe duke vazhduar me vlerësimin e strukturuar të kornizave LPP/LFT në raport me standardet ndërkombëtare në zhvillim e sipër.

Aktivitetet e asistencës teknike do të mbulojnë dy komponentë (korrupsionin dhe pastrimin e parave) duke trajtuar aspekte të ndërtimit të kapaciteteve të lidhura me krimin ekonomik në raport me reformat legjislativë, institucionale, politike dhe operacionale. Kapacitetet e përforcuara për të zbatuar dhe koordinuar në mënyrë efektive masat kundër korrupsionit do të shoqërohen me strukturimin e mëtejshëm të mekanizmave të shkëmbimit të informacionit dhe bashkëpunimit ndërmjet agjencive për të siguruar masa efektive të koordinuara kundër krimit ekonomik. Për më tepër, aktivitetet e asistencës teknike do të mbështesin autoritetet e Kosovës që të marrin pjesë më mirë në procesin e ardhshëm të vlerësimit që do të kryhet gjatë vitit të fundit të PECK II (2018).

PECK I zbatoi për herë të parë në Kosovë vlerësimet e strukturuar të efektivitetit dhe ndikimit të reformave dhe masave në fushat AK dhe LPP/LFT. Ekziston nevoja që të vazhdohet të mbështeten institucionet e Kosovës në kryerjen e këtij lloji të vlerësimeve gjithëpërfshirëse në dritën e standardeve përkatëse ndërkombëtare të përditësuara. PECK II do të sigurojë vazhdimësinë e përdorimit të metodologjive të njohura ndërkombëtarisht GRECO dhe MONEYVAL që do t'u mundësojnë

⁴⁵ Grupi punues bazë përfshinte përfaqësues nga NJIF-i, KKLEK-u, ATK-ja, PK-ja dhe projekti operacional ndërkombëtar në këtë fushë.

institucioneve relevante të Kosovës që të ndërmarrin masat e nevojshme për forcimin e luftës kundër korrupsionit dhe pastrimit të parave në Kosovë.

Ndërhyrjet nën PECK II do të synojnë të rrisin kapacitetet, sistemet dhe politikat për zbatimin e reformave të nevojshme të lidhura me krimin ekonomik në një nivel më të lartë profesional dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Nevojat dhe problemet e mëposhtme do të trajtohen nga ky projekt:

■ **Rritja e kapaciteteve institucionale për zbatimin dhe koordinimin e masave kundër korrupsionit**

- Futja e kapaciteteve të vlerësimit të rrezikut për të vlerësuar pengesat dhe vështirësitë rregullatore dhe institucionale

Duke pranuar faktin se mjetet e vlerësimit të rrezikut të korrupsionit janë ende në fazën fillestare, projekti do të ndihmojë në kryerjen e identifikimit adekuat dhe vlerësimit të rreziqeve të korrupsionit deri në 3 sektorë të rrezikshëm në Kosovë. Mjet i parë i vlerësimit të rrezikut që është në shtojcën e strategjisë aktuale kundër korrupsionit u përgatit edhe me mbështetjen dhe asistencën e Këshillit të Evropës. Gjatë vitit 2013 dhe 2014, u kryen tre vlerësime të rrezikut sektorial në shëndetësi, arsim dhe sektorin e energjisë, me mbështetjen e UNDP-së. Megjithatë, duhet të zhvillohen kapacitetet e brendshme për të menaxhuar dhe për të kryer një veprim të tillë në faza periodike dhe sidomos para çdo rishikimi tjetër të dokumenteve strategjike AK. Asistenca e propozuar do të synojë ngritjen dhe sigurimin të metodologjisë së vlerësimit të rrezikut për autoritetet vendore dhe ndërmarrjen e përbashkët të analizës së vlerësimit të rrezikut sektorial. Për më tepër, rezultatet e marra do të shërbejnë që të përdoren gjatë shqyrtimit të politikave, strategjive dhe planeve të veprimit kundër korrupsionit.

- Harmonizimi i legjislacionit kundër korrupsionit

Shqyrtimi dhe asistenca në hartimin ligjor të ligjeve dhe/ose rregulloreve përkatëse synojnë të trajtojnë fushat prioritare të identifikuar në raportet e vlerësimit PECK. Në lidhje me shembujt eventuale, harmonizimi adekuat mes Kodit Penal, Kodit të Procedurës Penale dhe legjislacionit tjetër përkatës nuk është adresuar ende. Rregullat dhe udhëzimet përkatëse për parandalimin dhe zbulimin e konfliktit të interesit, integritetin, pranimin e dhuratave, dyert rrotulluese dhe rregullat etike mungojnë në disa raste, ose vazhdojnë të reflektojnë mangësi të ndryshme. Më tej, ndjekja penale e lëndëve të lidhura me ryshfetin, parashkrimi, pendimi efektiv, përgjegjësia e personave juridikë, disa dispozita që kanë të bëjnë me fushëveprimin e konfiskimit të të ardhurave të lidhura me korrupsionin, nuk janë plotësisht në përputhje me standardet relevante ndërkombëtare. Së fundi, por jo për nga rëndësia, në lidhje me kornizën ligjore LPP/LFT, disa prej sfidave shumë të rëndësishme që duhet të trajtohen tërësisht janë dispozitat kontradiktore ose të paqëndrueshme në kodet përkatëse, standardet mospërputhëse të përdorura për provat, çështjet e sekuestrimit dhe konfiskimit, mungesa e kuadrit ligjor që do të mundësonte ngrirjen dhe konfiskimin e mjeteve të lidhura me terrorizmin.

- Shqyrtim dhe forcim i kornizës së dhënies së alarmit

Ka probleme me zbatimin e kuadrit ligjor dhe institucional të dhënies së alarmit (Ligji për mbrojtjen e informatorëve të vitit 2011), ndërsa niveli i besueshmërisë tek disa institucione publike është ende i ulët në mungesë të kanaleve të përshtatshme të raportimit dhe përcjelljes. Projekti do të asistojë në riorganizimin e kuadrit ekzistues të dhënies së alarmit në përputhje me standardet dhe praktikatat ndërkombëtare (d.m.th. Rekomandimi CM/Rec (2014)7 për mbrojtjen e denoncuesve i miratuar nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës më 30 prill 2014).⁴⁶

⁴⁶ Shih gjithashtu [Rezolutën 1729 \(2010\) të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës për mbrojtjen e alarmuesve](#) dhe [Udhëzimet e BE-së për alarmim](#), SEC (2012) 679 final, 6 dhjetor 2012.

- Forcimi i kapaciteteve hetuese të AKK-së dhe përmirësimi i cilësisë së kallëzimeve penale

Mospërputhja e rëndësishme mes rrjedhës së kallëzimeve penale të pranuar nga organet e ndjekjes dhe numrit të vogël të aktakuzave të mëvonshme dhe gjyqimeve të mëtejshme ngre shqetësime serioze për nevojat për të rritur kapacitetet e Agjencisë kosovare kundër Korrupsionit për përmirësimin efektiv të kapaciteteve hetuese dhe mbështetje e përcjelljen adekuate të agjencive të zbatimit të ligjit për të përmbushur në mënyrë efektive detyrimet e tyre. Asistenca e vazhdueshme teknike e financuar nga BE-ja po adreson kapacitetet hetuese të Policisë së Kosovës dhe në njëfarë mase të disa organeve të prokurorisë, por kjo nuk përfshin AKK-në.

- Shqyrtimi dhe përditësimi i strategjisë dhe planit të veprimit kundër korrupsionit

Ekziston një nevojë e qartë për të zhvilluar dhe/ose modernizuar mjetet dhe mekanizmat në dispozicion për raportimin dhe monitorimin e zbatimit të strategjisë dhe planit të veprimit kundër korrupsionit. Deri më sot, zbatimi i Strategjisë kundër korrupsionit 2013-2017 është mjaft i ulët në bazë të raporteve të monitorimit të AKK-së në dispozicion. Një vlerësim i ndikimit të kësaj strategjie pritet të bëhet rreth 2016-2017.

- Rritja e kapaciteteve të mekanizmave të deklarimit të pasurisë, konfliktit të interesit dhe integritetit

Duhet përforsimi adekuat i kuadrit dhe planeve të integritetit, si dhe kapaciteti për parandalimin e korrupsionit me fokus të veçantë në monitorimin efikas të deklarimeve të pasurisë dhe parandalimin dhe zbulimin e konfliktit të interesave në institucionet e administratës publike. Bashkëpunimi aktiv me shoqërinë civile dhe fushatat e ngritjes së vetëdijes janë të lidhura edhe me këto nevoja.

- Intensifikim i dialogut dhe bashkëpunimit mes autoriteteve publike dhe shoqërisë civile

Deri më sot, bashkëpunimi mes institucioneve relevante publike përgjegjëse në fushën e krimit ekonomik dhe organizatave të shoqërisë civile ka qenë i parregullt, jo shumë konstruktiv dhe pa konsultime periodike, pa të dhëna të lidhura me politikat dhe pa mjete të strukturuar të bashkëpunimit. Ka një Strategji Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2013-2017 që ka për qëllim të adresojë një bashkëpunim të tillë.

■ Përforsim i bashkëpunimit ndërmjet agjencive dhe shkëmbimit të informacionit

Mekanizmat ekzistues të bashkëpunimit ndërmjet agjencive duhet të rishikohen dhe mangësitë përkatëse duhet të analizohen me ndihmën e agjencive kryesore ekzekutive. Përveç kësaj, platforma e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet agjencive duhet të vendoset, të strukturohet dhe të përmirësohet përmes një zinxhiri të efektshëm të llogaridhënies. Për më tepër, duhet të vendosen dhe/ose të zhvillohen PSV-të, manualët dhe udhëzimet ndërmjet agjencive, si dhe mekanizmat e përmirësuar për monitorim, vlerësim dhe raportim mbi zbatimin e dokumenteve të politikave dhe planeve të veprimit përmes kapaciteteve të shtuara të agjencive të koordinimit dhe mjeteve teknike të nivelit koordinues (grup punues ose të ngjashme). Projekti do të ofrojë mbështetje të drejtpërdrejtë në këto procese.

- Shqyrtimi dhe analiza e hendekut e mekanizmave dhe përvojës ekzistuese të bashkëpunimit ndërinstitutional

Mungesa e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet agjencive, së bashku me zbatimin e pamjaftueshëm të ligjeve dhe rregulloreve ekzistuese, ka pasur një ndikim të madh në llogaridhënien dhe besimin në institucionet. Veprimi i koordinuar mes institucioneve është një vështirësi e madhe, kur shumica e veprimeve kryhen ose pritet të kryhen përmes projekteve individuale.

Ka mungesë të përvojës shumë fillestare në ndërmarrjen e veprimeve të përbashkëta, eksplorimin dhe ofrimin e mundësive të ndryshme për shkëmbimin e informacionit ndërmjet agjencive dhe institucioneve dhe sigurimin e reagimeve të duhura dhe të nevojshme, si dhe përdorimin e mjeteve dhe metodave të duhura të monitorimit.

Projekti do të fokusohet veçanërisht në bashkëpunimin efikas vertikal dhe horizontal ndërmjet institucioneve të parandalimit dhe zbatimit të ligjit. Mjetet adekuate për komunikim të duhur mes institucioneve relevante në fushën e krimit ekonomik do të promovohen nëpërmjet forcimit të mekanizmave për shkëmbimin dhe verifikimin e të dhënave (me qëllim për të adresuar *ndër të tjera* humbjen e dokumenteve, mungesën e monitorimit të rrjedhës së rastit, afatet e pamjaftueshme dhe veprimet reaguese, vështirësitë në përditësimin e statusit të rasteve, ndërveprimin dhe disponueshmërinë e të dhënave në të gjitha agjencitë e zbatimit të ligjit dhe agjencitë e tjera, mekanizmat e rregullta të informatave kthjese, metodologjitë e harmonizuara për mbledhjen dhe shkëmbimin e të dhënave, si dhe për raportimin statistikor).

Në lidhje me këtë, mekanizmat ekzistues të bashkëpunimit ndërmjet agjencive duhet të rishikohen dhe mangësitë përkatëse duhet të analizohen me ndihmën e agjencive kryesore ekzekutive. Veprimi do të mbështesë zhvillimin e analizës së hendekut në kuadrin përkatës rregullator dhe do të ndihmojë për të nxitur metodologjitë e duhura.

- Krijimi, strukturimi dhe përmirësimi i mekanizmit/strukturës së bashkëpunimit ndërmjet agjencive

Do të ofrohet mbështetje strategjike dhe praktike për të identifikuar nevojat dhe hendeqet në bashkëpunimin ndërinstitucional në fushën e krimit ekonomik, për të mbështetur përditësimin dhe riorganizimin e platformave të bashkëpunimit, procedurave, udhëzimeve dhe praktikave si dhe mekanizmave konkrete për shkëmbimin e informacionit dhe informatave kthjese ndërmjet agjencive dhe institucioneve përkatëse. Në fushën e luftës kundër korrupsionit, ka mbivendosje të strukturave koordinuese, përfshirje pasive të institucioneve përkatëse të ekzekutivit dhe vështirësi nga AKK-ja për të siguruar koordinim qendror dhe/ose për të marrë mbështetjen e duhur nga aktorë të tjerë.

- Zhvillimi i PSV-ve ndërmjet agjencive, manualeve dhe udhëzimeve në lidhje me krimin ekonomik

PSV-të ndërmjet agjencive, manualët dhe udhëzimet duhet të vendosen dhe/ose të zhvillohen/përmirësohen në mënyrë që të mbështetet zbatimi i nevojave të lartpërmendura nën këtë komponent.

- Përmirësim i monitorimit, vlerësimit dhe raportimit mbi zbatimin e dokumenteve të politikave të krimit ekonomik dhe planeve të veprimit

Duhet të rishqyrtohen dhe/ose të zhvillohen mekanizmat e përmirësuar për monitorim, vlerësim dhe raportim mbi zbatimin e dokumenteve të politikave dhe planeve të veprimit përmes kapaciteteve të shtuara të agjencive të koordinimit dhe mjeteve teknike të nivelit koordinues (grup punues ose të ngjashme).

Rezultati i pritur i përgjithshëm do të jetë kapaciteti i përforcuar dhe mekanizmat e efektshëm në dispozicion të organeve përkatëse kundër korrupsionit, në veçanti të AKK-së, për të menaxhuar, koordinuar dhe monitoruar programin dhe përpjekjet kundër korrupsionit.

■ Vlerësim i strukturuar dhe gjithëpërfshirës për LKK dhe LPP/LFT në përputhje me standardet përkatëse evropiane dhe ndërkombëtare

Dy komponentët e tjerë të mbetur të këtij projekti do të fokusohen në procesin gjithëpërfshirës dhe të strukturuar të vlerësimit kundrejt standardeve të rishikuara ndërkombëtare, kur janë në dispozicion dhe në vend, si dhe në nevojën për të përcaktuar përparësitë dhe adresuar në mënyrë adekuate sfidat dhe rekomandimet e dala nga PECK I. Vlerësimi i përputhshmërisë me standardet evropiane dhe ndërkombëtare në fushat e LKK dhe LPP/LFT do të bazohet në metodologjitë e vlerësimit në zhvillim të GRECO dhe MONEYVAL të Këshillit të Evropës dhe të përshtatura në mënyrë specifike për Kosovën. Vazhdimësia e vlerësimit dhe të kuptuarit dhe kapaciteti i rritur i institucioneve të Kosovës për të mbështetur dhe për të aplikuar vlerësimet kolegjiale do të kontribuojë ndjeshëm në rritjen e pronësisë së procesit nga përfituesit. Për më tepër, asistenca dhe mbështetja në zbatimin e rekomandimeve të PECK I do të ofrohen në mënyrë adekuate.

Për shkak të gjendjes së statusit të saj, Kosova nuk i nënshtrohet asnjërit mekanizëm të vlerësimit. Teksa reformat që lidhen me korrupsionin dhe pastrimin e parave janë zhvilluar prej disa vitesh, nuk ka pasur proces të strukturuar më afatgjatë për të vlerësuar progresin dhe ndikimin e tyre. Disa ushtrime vlerësimi të izoluar ose vrojtme specifike periodike kryhen nga aktorë të ndryshëm ndërkombëtarë dhe kombëtarë dhe përfshijnë edhe Kosovën, por pa një përfshirje të strukturuar dhe të drejtpërdrejtë të përfituesve. Po ashtu, nuk kishte as procedura të pajtueshmërisë në dispozicion, as nuk kishte standarde koherente dhe gjithëpërfshirëse si kriteret e vlerësimit.

Në këtë kontekst, projekti PECK I ndërmori tre vjet më parë një detyrë të tillë të plotë: të kryejë një proces gjithëpërfshirës dhe të strukturuar të vlerësimit, siç bëhet bërë nga organet monitoruese të Këshillit të Evropës. Edhe pse Kosova nuk mund të marrë pjesë dhe të përfitojë direkt nga GRECO dhe MONEYVAL, përvoja dhe kriteret e përdorura nga të dy organet monitoruese vërtetuan se janë të dobishme në qoftë se të përshtaten në mënyrë specifike për Kosovën, pasi kjo është demonstruar në mënyrë të qartë gjatë zbatimit të PECK-ut. Këto organe monitorimi mund të jenë kuadri i tërthortë i referencës për vlerësimin e masave kundër korrupsionit dhe pastrimit të parave në Kosovë, si dhe përgatitjen e rekomandimeve për reforma.

Në këtë kontekst, standardet relevante të aplikueshme evropiane dhe ndërkombëtare do të lejojnë që vlerësimet të jenë të bazuara në një grup të plotë dhe të unifikuar të rregullave.

Për këtë arsye, një vlerësim i strukturuar dhe i rregullt do të lejojë ndikimet pozitive në vijim në lidhje me nevojat e përfituesve:

- Institucionet qeveritare do të zhvillojnë ose përmirësojnë mekanizmat e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave të nevojshme për raportimin mbi reformat kundër korrupsionit;
- Institucionet qeveritare do të forcojnë kapacitetet e tyre të raportimit në përputhje me metodologjinë e vlerësimit për luftën kundër korrupsionit (institucionet qeveritare kanë marrë pjesë në një vlerësim gjithëpërfshirës ndërkombëtar kundrejt standardeve ndërkombëtare dhe evropiane gjatë zbatimit të PECK-ut, ka një përvojë të mëparshme të suksesshme praktike për të tilla ushtrime me të gjitha mësimet e nxjerra në lidhje me procesin, specifikat e brendshme dhe nevojat specifike);
- Institucionet qeveritare mund t'i bazojnë vendimet e tyre të politikës dhe legjislacionit në një vlerësim gjithëpërfshirës dhe koherent në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare;
- Përfshirja e institucioneve qeveritare në procedurën e vlerësimit do të kontribuojë në sqarimin e kompetencave dhe për bashkëpunimin mes agjencive;
- Rekomandimet specifike do të lejojnë veprime të menjëhershme legjislative ose organizative;
- Do të mund të ndiqet progresi i zbatimit të rekomandimeve;
- Vlerësimet mbi pastrimin e parave do të mbështesin anëtarësimin e Kosovës në Egmont Group;
- Rritja e ndërgjegjësimit të publikut nëpërmjet procedurës së vlerësimit;
- Rritja e besimit dhe njohjes me sistemet kundër korrupsionit dhe kundër pastrimit të parave në Kosovë nga investitorët e huaj, si rezultat i vlerësimeve.

4 ASISTENCË TJETËR TEKNIKE RELEVANTE NDËRKOMBËTARE

Në fushën e luftës kundër korrupsionit, institucioni kryesor përfitues - Agjencia Kundër Korrupsionit e Kosovës - aktualisht nuk merr ndonjë asistencë të madhe teknike pas përfundimit të Projektit PECK I, përveç përfshirjes së saj të mëparshme në Projektin SAEK të zbatuar nga UNDP-ja dhe asistencës së Bankës Botërore në aspektet e lidhura me prokurimin publik. As Njësia e Inteligjencës Financiare nuk përfiton drejtpërdrejt nga asistencë ekzistuese.

Projekte të tjera të rëndësishme të cilat janë në proces apo të planifikuara që do të mbështeten përmes asistencës teknike ndërkombëtare janë:

- Projekti i BE-së i binjakëzimit "Forcimi i Kapaciteteve të hetimit penal kundër Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit", - € 2,0 milionë (IPA 2012), 2014-2016;
- Projekti i financuar nga BE-ja "Mbështetje për Agjencinë për Menaxhimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar", € 1,0 milion (IPA 2011), 2013-2016;
- Mbështetje për Këshillat Gjyqësor dhe Prokurorial të Kosovës, 1,89 milionë euro (IPA 2010), 2011-2016;
- Mbështetje për përpjekjet kundër korrupsionit në Kosovë (SAEK), € 2,16 milionë (Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, MPJ Norvegjeze), 2012-2016;
- Mbështetje për përpjekjet kundër korrupsionit në Kosovë (SAEK II), 2016-2019 - Danida dhe Bashkëpunimi Zviceran përmes zbatimit të UNDP-së;
- Programi i Forcimit të Sistemit të Drejtësisë (JSSP), i cili është menduar të mbulojë aktivitetet e lidhura me luftën kundër korrupsionit, po instalohet nga USAID. Ai synon të përmirësojë sundimin e ligjit dhe qeverisjen e mirë në Kosovë, duke forcuar pavarësinë, profesionalizmin, efikasitetin dhe llogaridhënien e sistemit të drejtësisë. Në mënyrë të veçantë, programi kërkon:
 - (1) të forcojë efikasitetin dhe efektivitetin në administrimin e drejtësisë dhe ofrimin e shërbimeve cilësore nga ana e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) dhe gjykatave;
 - (2) të rrisë llogaridhënien dhe profesionalizmin e institucioneve dhe aktorëve të sistemit të drejtësisë; dhe
 - (3) të mbështesë funksionimin dhe integrimin e strukturave gjyqësore në veri.

5 PËRMBLEDHJE E REZULTATEVE/QËLLIMEVE TË PROJEKTIT

5.1 Aktivitete

Objektivi i përgjithshëm	Të kontribuohet për demokracinë dhe shtetin e së drejtës nëpërmjet parandalimit dhe kontrollit të korrupsionit, pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në Kosovë.	
Qëllimi i projektit	Të forcohen kapacitetet institucionale për të luftuar korrupsionin, pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit në Kosovë në përputhje me standardet evropiane përmes vlerësimeve të plota dhe rekomandimeve për përmirësimin dhe modernizimin e reformave të krimit ekonomik.	
Rezultati i pritur 1:	Kapacitetet institucionale të aktorëve të përfshirë në luftën kundër korrupsionit për të zbatuar dhe koordinuar në mënyrë efektive masat kundër korrupsionit janë forcuar më tej	
Aktiviteti	Veprimet	Të arritshmet / Kostot / Inputet
1.1.	Kryerja e analizës së rrezikut dhe vlerësimeve (deri në tre fusha prioritare siç janë identifikuar në Raportin e Vlerësimit fillestar nga PECK I) në mënyrë që të vlerësohen pengesat rregullatore dhe institucionale për të parandaluar dhe luftuar korrupsionin në mënyrë efektive	Sektorët dhe institucionet e synuara të identifikuar në bazë të kritereve të qarta, vlerësimi paraprak dhe identifikimi i burimeve të informacionit, deri në 3 raporte sektoriale për vlerësimin e rrezikut të përfunduar, të shpërndara dhe të publikuara, Udhëzuesi i Vlerësimit të Rrezikut të Korrupsionit i dorëzuar, shpërndarë dhe publikuar. <i>Kosto:</i> Tarifat e KASH-ve, mëditjet, udhëtimi ndërkombëtar, studime/kërkime, dokumente teknike, konferenca / punëtori / ngjarje dhe materiale të dukshmërisë, trajnime duke përfshirë trajnimin e trajnerëve, përkthim / interpretim, publikim dhe shpërndarje. <i>Inputet:</i> Këshilla nga ekspertë, konsultim nga KASH-e, mendime juridike, hulumtim studimor.
1.2	Ofrim i mendimeve ligjore dhe teknike dhe propozimeve legjislative dhe mbështetje e zbatimit të tyre për ta sjellë legjislacionin përkatës kundër korrupsionit në përputhje me standardet ndërkombëtare	Ofrim i shqyrtimit të të paktën 6 ligjeve përkatëse (d.m.th. kuadri bazë kundër korrupsionit, legjislacioni dhe rregulloret LPP/LFT, konflikti i interesave dhe parandalimi i integritetit, përgjegjësia e personave juridikë, inkriminimet në Kodin Penal, Kodi i Procedurës Penale, sekuestrimi dhe konfiskimi i të ardhurave kriminale...) dhe këshilla për ndryshime në legjislacionin përkatës në mënyrë që të përputhet me standardet relevante ndërkombëtare siç rekomandohet nga Raportet e Vlerësimit të PECK-ut Dokumenti i Metodologjisë dhe sesione trajnimi për Mbrojtje nga Korrupsioni. <i>Kosto:</i> Tarifat e KASH-ve, mëditjet, udhëtimi ndërkombëtar, studime / kërkime, dokumente teknike, seminar / punëtori / ngjarje të dukshmërisë dhe materiale, përkthim / interpretim, publikim dhe shpërndarje. <i>Inputet:</i> Këshilla nga ekspertë, konsultim nga KASH-e, mendime juridike, studim krahasues.
1.3	Shqyrtimi i mekanizmave ligjore dhe institucionale për dhënien e alarmit dhe	Analiza ligjore dhe teknike dhe rishikimi i kuadrit ligjor për alarmim me rekomandimet për përmirësim të mëtejshëm; analiza e mangësive dhe defekteve

	ofrimi i propozimeve për përmirësim	<p>institucionale dhe operacionale të sistemit të alarmimit; Udhëzim dhe këshilla për sistemet institucionale të menaxhimit dhe procedurat, kanalet për raportimin e rasteve të lidhura me korrupsionin dhe përcjellja e përshtatshme; Doracaku për Mbrojtjen e alarmuesit.</p> <p><i>Kosto:</i> Tarifat e KASH-ve, mëditjet, udhëtimi ndërkombëtar, dokumente teknike, seminar / punëtori / ngjarje dhe materiale të dukshmërisë, përkthim / interpretim, publikim dhe shpërndarje.</p> <p><i>Inputet:</i> Këshilla nga ekspertë, konsultim nga KASH-e, analiza dhe rishikimi ligjor dhe teknik</p>
1.4	Forcimi i kapaciteteve hetuese të AKK-së dhe përmirësimi i cilësisë së raportimit tek autoritetet e zbatimit të ligjit, si rezultat i zhvillimit dhe/ose rishikimit të metodologjive, udhëzimeve dhe procedurave standarde të veprimit (PSV-ve)	<p>Rishikimi i kuadrit ligjor, institucional dhe operacional të AKK-së; 2 dokumente teknike mbi bazën e rishikimit me këshilla/udhëzime, rekomandime dhe praktika të mira; Mbështetje e kapaciteteve të vizibilitetit dhe komunikimit të AAKK-së dhe ofrim i veprimeve dhe materialeve të ndërgjegjësimit; sesione të specializuara trajnimi për zbulimin, hetimin, ndjekjen dhe gjykimin e veprave penale që lidhen me korrupsionin; deri në dy vizita studimore për të mësuar dhe ndarë praktikat më të mira në fushën e rasteve të korrupsionit.</p> <p><i>Kosto:</i> Tarifat e KASH-ve, mëditjet, udhëtimi ndërkombëtar, studime/kërkime, dokumente teknike, punëtori /seminare / ngjarje dhe materiale të dukshmërisë, sesione trajnimesh të specializuara, vizita studimore, përkthim / interpretim, publikim dhe shpërndarje.</p> <p><i>Inputet:</i> Këshilla nga ekspertë, konsultim nga KASH-e, analiza dhe rishikimi ligjor dhe teknik, dokumente teknike të trajnimit, mbështetje e vizibilitetit dhe komunikimit.</p>
1.5	Shqyrtimi dhe përditësimi i planit të veprimit kundër korrupsionit të Kosovës	<p>Mbështetje teknike dhe këshilla për AKK-në dhe institucionet e përfshira publike në lidhje me sistemin e raportimit kundër korrupsionit dhe mjetet metodologjike të monitorimit; ngjarje vjetore për të monitoruar progresin në zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër korrupsionit; asistencë për hartimin e dokumenteve të njëpasnjëshme të reja të politikave strategjike AK, duke përfshirë mjetet e vlerësimit të rrezikut; metodologjitë dhe format e standardizuara për hartimin e planeve të veprimit kundër korrupsionit (duke përfshirë treguesit e performancës).</p> <p><i>Kosto:</i> Tarifat e KASH-ve, mëditjet, udhëtimi ndërkombëtar, dokumente teknike, seminar / punëtori / ngjarje dhe materiale të dukshmërisë, sesione trajnimi, përkthim / interpretim, publikim dhe shpërndarje.</p> <p><i>Inputet:</i> Këshilla nga ekspertë, konsultim nga KASH-e, dokumente teknike, udhëzime dhe forma, rishikimi dhe rekomandimet.</p>
1.6	Ofrim i metodologjive, udhëzimeve dhe mjeteve	Metodologji, udhëzime, mjete dhe kapacitete të trajnimit për menaxhimin dhe monitorimin efektiv të

	në zbatimin e deklaramit të pasurisë dhe kuadrit rregullator mbi konfliktin e interesave, për AAK-në, zyrtarë të qeverisë, gazetarë hulumtues dhe OJQ-të	<p>deklarimit të pasurisë; mangësitë e sistemit të integritetit, parandalimi i konfliktit të interesit dhe integritetit, testit/testet e integritetit; elaborimi dhe zbatimi i planeve dhe materialeve të trajnimit, duke përfshirë trajnimin e trajnerëve, për çështjet e konfliktit të interesit dhe integritetit</p> <p><i>Kosto:</i> Tarifat e KASH-ve, mëditjet, udhëtimi ndërkombëtar, studime/kërkime, dokumente teknike, punëtori /seminare / ngjarje dhe materiale të dukshmërisë, sesione trajnimesh të specializuara, përkthim / interpretim, publikim dhe shpërndarje.</p> <p><i>Inputet:</i> Këshilla nga ekspertë, konsultim nga KASH-e, dokumente teknike, udhëzime dhe doracak, kurrikula e trajnimit.</p>
1.7	Mbështetje e dialogut dhe procesit të konsultimit ndërmjet autoriteteve publike dhe organizatave të shoqërisë civile në nismat e reformës kundër korrupsionit	<p>Asistencë në përmirësimin e mekanizmave koordinuese për shkëmbimin e informacionit dhe konsultimin e OJQ-ve aktive në fushën e luftës kundër korrupsionit; mbështetja e rolit dhe angazhimit të shoqërisë civile në monitorimin dhe raportimin e korrupsionit; rritja e kapaciteteve për gazetari hulumtuese dhe përdorimi i teknologjive të reja; rritja e ndërgjegjësimit publik për parandalimin e korrupsionit dhe promovimi i integritetit</p> <p><i>Kosto:</i> Tarifat e KASH-ve, mëditjet, udhëtimi ndërkombëtar, dokumente teknike, seminar / punëtori / ngjarje dhe materiale të dukshmërisë, sesione trajnime të specializuara, përkthim / interpretim, publikim dhe shpërndarje.</p> <p><i>Inputet:</i> Këshilla nga ekspertë, konsultim nga KASH-e, dokumente teknike, materiale të vetëdijësimit dhe shtrirjes publike, kurrikula e trajnimit.</p>
Rezultati i pritur 2:	Mekanizmat e shkëmbimit të informacionit dhe bashkëpunimit mes agjencive janë strukturuar për të siguruar masa efektive të koordinuara kundër krimit ekonomik	
Aktivitetet	Veprimet	Të arritshmet / Kostot / Inputet
2.1	Asistim i AKK-së dhe NJIF-it (duke përfshirë këtu Policinë, Tatimet, Doganat dhe Shërbimet e Prokurorisë) për të kryer shqyrtime dhe analiza të mangësive të mekanizmave të tyre të bashkëpunimit ndërinstitucional	<p>Shqyrtime dhe studime të analizave të hendekut të kryera (në fushat LKK dhe LPP/LFT) në mekanizmat ekzistuese të bashkëpunimit ndërinstitucional dhe rekomandime të dorëzuara për përmirësim dhe riorganizim; hulumtim dhe asistencë për praktikat e mira për qasje në informata, modalitetet e shkëmbimit të informacionit dhe portalet e ngjashme të bashkëpunimit; punëtori për veprime të përbashkëta mes AZL-ve, qasje në informacion dhe shkëmbim i informacionit dhe informatave kthyesë mes agjencive, monitorimi dhe mjetet e metodat e duhura të përcjelljes.</p> <p><i>Kosto:</i> Tarifat e KASH-ve, mëditjet, udhëtimi ndërkombëtar, studime/kërkime, dokumente teknike, punëtori / seminar / ngjarje dhe materiale të dukshmërisë, trajnime duke përfshirë trajnimin e trajnerëve, përkthim / interpretim, publikim dhe shpërndarje.</p> <p><i>Inputet:</i> Këshilla nga ekspertë, konsultim nga KASH-</p>

		e, dokumente teknike, hulumtim.
2.2	Ofrim i rekomandimeve dhe mbështetje e zbatimit të tyre me qëllim të përmirësimit të mekanizmit të bashkëpunimit mes agjencive	Mjete metodologjike me qëllim të përmirësimit dhe të mirë të mekanizmit të bashkëpunimit dhe koordinues mes agjencive dhe mbështetje për krijimin dhe/ose rritjen e strukturave të bashkëpunimit dhe koordinimit. <i>Kosto:</i> Tarifat e KASH-ve, mëditjet, udhëtimi ndërkombëtar, dokumente teknike, seminar / punëtori / ngjarje dhe materiale të dukshmërisë, përkthim / interpretim, publikim dhe kopjim. <i>Inputet:</i> Këshilla nga ekspertë, konsultim nga KASH-e, dokumente teknike.
2.3	Zhvillimi i PSV-ve ndërmjet agjencive, manualeve dhe udhëzimeve në lidhje me krimin ekonomik	Asistencë në zhvillimin dhe/ose rishikimin e dispozitave të PSV-ve që lidhen me bashkëpunimin mes agjencive; udhëzime dhe manuale mbi mjetet standarde për bashkëpunim mes agjencive; trajnime shumëdisiplinore për çështjet e mekanizmit të bashkëpunimit mes agjencive, bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit; mbështetje dhe promovim i lidhjes së MM-ve të nevojshme dypalëshe ose shumëpalëshe ose pjesëmarrje e institucioneve kryesore në rrjetet relevante ndërkombëtare. <i>Kosto:</i> Tarifat e KASH-ve, mëditjet, udhëtimi ndërkombëtar, dokumente teknike, punëtori / seminar / ngjarje dhe materiale të dukshmërisë, trajnime duke përfshirë trajnimin e trajnerëve, vizita studimore, përkthim / interpretim, publikim dhe shpërndarje. <i>Inputet:</i> Këshilla nga ekspertë, konsultim nga KASH-e, dokumente teknike, kurrikula shumëdisiplinore e trajnimit.
2.4	Përmirësim i monitorimit, vlerësimit dhe raportimit mbi dokumentet e politikave të krimit ekonomik dhe planet e veprimit	Sesione trajnimi mbi mjetet e raportimit, shabllonet standarde dhe mbledhja e informacionit; zhvillimi i indikatorëve për të vlerësuar/matur nivelin e implementimit të dokumenteve të politikave dhe planeve të veprimit të krimit ekonomik; vlerësimi / përcjellja e progresit të bërë në drejtim të kapaciteteve të monitorimit dhe raportimit. <i>Kosto:</i> Tarifat e KASH-ve, mëditjet, udhëtimi ndërkombëtar, dokumente teknike, seminar / punëtori / ngjarje dhe materiale të dukshmërisë, sesione trajnimi, përkthim / interpretim, publikim dhe shpërndarje. <i>Inputet:</i> Këshilla nga ekspertë, konsultim nga KASH-e, dokumente teknike, materiale trajnimi.
Rezultati i prituri 3:	Raporti i vlerësimit të masave kundër korrupsionit është në dispozicion	
Aktiviteti	Veprimet	Të arritshmet / Kostot / Inputet
3.1.	Raporti i vlerësimit kundër korrupsionit në dispozicion për nivelin e pajtueshmërisë së rregulloreve dhe praktikave në fuqi me	Fillimi i procedurës që do të mbështesë fillimin e vlerësimit për masat kundër korrupsionit: përgatitja dhe finalizimi i TR-ve dhe pyetësorit; përgatitja e një matricë të pajtueshmërisë dhe vendosja e prioritetet në lidhje me vlerësimin e korrupsionit. <i>Kosto:</i> Tarifat për ekspertët e vlerësimit, KASH-et,

	standardet evropiane dhe ndërkombëtare (bazuar në përvojën dhe kriteret e përdorura nga GRECO dhe organet e tjera relevante të Këshillit të Evropës);	mëditjet, udhëtimi ndërkombëtar, studime / hulumtime, përkthim / interpretim, publikim dhe shpërndarje, kosto punëtorie dhe konference, ngjarjet dhe materialet e vizibilitetit, pyetësi i vlerësimit, matrica e pajtueshmërisë, raporti i vlerësimit dhe dokumentet e lidhura të vlerësimit. <i>Inputet:</i> Këshilla nga ekspertë vlerësimi, konsultim nga KASH-e, mendime juridike, hulumtim studimor.
3.2	Mbështetje dhe lehtësim i pjesëmarrjes aktive të institucioneve të Kosovës në vlerësime kolegjiale të masave kundër korrupsionit, bazuar në metodologjinë e monitorimit evropian	Organizim i vlerësimit për masat kundër korrupsionit, duke përfshirë matricën e pajtueshmërisë; mbështetje e institucioneve të Kosovës në rritjen e kapaciteteve të tyre raportuese në përputhje me metodologjinë e vlerësimit për masat/reformat kundër korrupsionit dhe zhvillimin e mekanizmave të grumbullimit dhe përpunimit të të dhënave të nevojshme për raportim për masat/reformat kundër korrupsionit. <i>Kosto:</i> Tarifat për ekspertët e vlerësimit, KASH-et, mëditje, kosto udhëtimi ndërkombëtar, punëtorja, përkthimi / interpretimi. <i>Inputet:</i> Këshilla nga ekspertë vlerësimi, konsultim nga KASH-e, mendime juridike.
3.3	Rekomandimet e bazuara në vlerësim në dispozicion për fushat rregullatore, institucionale dhe të politikave të lidhura me luftën kundër korrupsionit	Përgatitja dhe paraqitja e rekomandimeve të bazuara në vlerësim dhe sigurimi i të kuptuarit të unifikuar të reformave të propozuara. <i>Kosto:</i> Tarifat për ekspertët e vlerësimit, KASH-et, mëditje, kosto udhëtimi ndërkombëtar, punëtorja, përkthimi / interpretimi. <i>Inputet:</i> Këshilla nga ekspertë vlerësimi, konsultim nga KASH-e, mendime juridike.
3.4	Raporti i vlerësimit kundër korrupsionit (duke përfshirë matricën e pajtueshmërisë) është publikuar dhe shpërndarë në anglisht, shqip dhe serbisht.	Publikim, përkthim, shpërndarje dhe ndërgjegjësim për vlerësimin (duke përfshirë matricën e pajtueshmërisë) në anglisht, shqip dhe serbisht. <i>Kosto:</i> Tarifat për ekspertët e vlerësimit, KASH-et, mëditje, kosto udhëtimi ndërkombëtar, konferenca, përkthimi / interpretimi, publikimi dhe shpërndarja. <i>Inputet:</i> Këshilla nga ekspertë vlerësimi, konsultim nga KASH-e, mendime juridike.
Rezultati i pritur 4:	Raporti i vlerësimit të masave kundër pastrimit të parave dhe luftës kundër financimit të terrorizmit është në dispozicion	
Aktiviteti	Veprimet	Të arritshmet / Kostot / Inputet
4.1	Raporti i vlerësimit në dispozicion për nivelin e pajtueshmërisë së rregulloreve dhe praktikave në fuqi me standardet evropiane (bazuar në përvojën dhe kriteret e përdorura nga MONEYVAL dhe organet e tjera relevante ndërkombëtare)	Fillimi i procedurës që do të mbështesë fillimin e vlerësimit për masat kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit: përgatitja dhe finalizimi i TR-ve dhe pyetësorit; përgatitja e një matricë të pajtueshmërisë dhe vendosja e prioritetet në lidhje me vlerësimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. <i>Kosto:</i> Tarifat për ekspertët e vlerësimit, KASH-et, mëditje, kosto udhëtimi ndërkombëtar, punëtorja, konferenca, përkthimi / interpretimi, publikimi dhe shpërndarja. <i>Inputet:</i> Këshilla nga ekspertë vlerësimi, konsultim nga KASH-e, hulumtim studimor, mendime juridike,

		take.
4.2	Mbështetje dhe lehtësim i pjesëmarrjes aktive të institucioneve të Kosovës në vlerësime kolegjiale të masave kundër pastrimit të parave dhe luftimit të financimit të terrorizmit, bazuar në metodologjinë e monitorimit evropian	Organizim i vlerësimit për masat kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit; mbështetje e institucioneve të Kosovës në rritjen e kapaciteteve të tyre raportuese në përputhje me metodologjinë e vlerësimit dhe zhvillimin e mekanizmave të grumbullimit dhe përpunimit të të dhënave të nevojshme për raportim për masat/reformat LPP/LFT. <i>Kosto:</i> Tarifat për ekspertët e vlerësimit, KASH-et, mëditje, kosto udhëtimi ndërkombëtar, punëtorja, përkthimi / interpretimi. <i>Inputet:</i> Këshilla nga ekspertë vlerësimi, konsultim nga KASH-e, mendime juridike.
4.3	Janë në dispozicion rekomandimet e bazuara në vlerësim për fushat rregullatore, institucionale dhe të politikave të lidhura	Përgatitja dhe paraqitja e rekomandimeve të bazuara në vlerësim dhe sigurimi i të kuptuarit të unifikuar të reformave të propozuara. <i>Kosto:</i> Tarifat për ekspertët e vlerësimit, KASH-et, mëditje, kosto udhëtimi ndërkombëtar, punëtori, përkthimi / interpretimi, publikimi dhe shpërndarja. <i>Inputet:</i> Këshilla nga ekspertë vlerësimi, konsultim nga KASH-e, mendime juridike.
4.4	Është publikuar dhe shpërndarë raporti i vlerësimit LPP/LFT (përfshirë matricën e pajtueshmërisë) në anglisht, shqip dhe serbisht.	Publikim, përkthim, shpërndarje dhe ndërgjegjësim për vlerësimin (duke përfshirë matricën e pajtueshmërisë) në anglisht, shqip dhe serbisht. <i>Kosto:</i> Tarifat për ekspertët e vlerësimit, KASH-et, mëditje, kosto udhëtimi ndërkombëtar, përkthimi / interpretimi, publikimi dhe shpërndarja. <i>Inputet:</i> Këshilla nga ekspertë vlerësimi, konsultim nga KASH-e, mendime juridike, vizita studimore

5.2 Inputet

Projekti do të sigurojë inputet e mëposhtme duke mbështetur dhe asistuar arritjen e rezultateve të pritshme në përputhje me planin e miratuar të punës dhe nevojat në zhvillim siç është rënë dakord në mënyrë të përshtatshme me anë të mbledhjeve të Këshillit Drejtues:

- Hulumtime studimore;
- Këshilla/opinione të ekspertëve;
- Tryeza të rumbullakëta dhe seminare;
- Punëtori dhe konferenca;
- Kurse trajnimi, duke përfshirë trajnimin e trajnerëve;
- Vizita vlerësimi në terren;
- Vizita studimore;
- Përkthim / Interpretim;
- Publikim / përhapja;
- Mbulimi mediatik dhe veprimet e vizibilitetit.

5.3 Të arritshmet

Të arritshmet sipas rezultateve të pritshme 1 dhe 2 do të përfshijnë:

- Raportet e vlerësimit të rrezikut me rekomandime konkrete si të adresohen rreziqet dhe kërcënimet e korrupsionit;
- Trajnime (shumëdisiplinore dhe të specializuara), materiale dhe kurrikula;
- Këshilla ligjore dhe teknike, mendime dhe rekomandime;
- Projektakte rregullatore;
- Mjete/ngjarje/punëtori ndërgjegjësimi dhe dukshmërie;
- Hulumtime studimore;
- Publikime dhe materiale informative;
- Punëtori dhe konferenca;
- Vizita studimore.

Sipas rezultateve të pritshme 3 dhe 4 të arritshmet do të përfshijnë:

- Termat e referencës mbi metodologjinë dhe procedurën e vlerësimit;
- Raportet e vlerësimit LKK dhe LPP/LFT dhe matricat e pajtueshmërisë;
- Trajnime (sesione informimi) mbi metodologjinë e vlerësimit ndërkombëtar si ushtrime;
- Punëtori dhe aktivitete të trajnimit mbi ushtrimet dhe metodologjitë e vlerësimit ndërkombëtar;
- Konferenca (sesione plenare ku diskutohen rezultatet e vlerësimeve).

6 AKTIVITETET FILLESTARE

6.1 Përmbledhje e veprimeve

Aktivitetet dhe veprimet e mëposhtme janë kryer gjatë fazës fillestare të projektit dhe para aktiviteve për lansim (01 janar 2016 - 31 mars 2016):

Përshkrimi i aktiviteve të fazës fillestare	Statusi (prej 31 marsit 2016)
<p>Rekrutimi i ekipit të projektit (Strasburg dhe Prishtinë):</p> <ul style="list-style-type: none"> • Këshilltar i projektit (Prishtinë - me kohë të plotë): I rekrutuar dhe operativ • Zyrtar i lartë i projektit (Prishtinë - me kohë të plotë): Rekrutimi i finalizuar, stafi është operativ në prill 2016 • Asistenti gjuhësor i projektit (Prishtinë - me kohë të plotë): Rekrutimi i finalizuar, stafi është operativ pas përfundimit të periudhës së njoftimit • Menaxher i projektit (Strasburg - me 50% kohë): I rekrutuar dhe operativ • Asistent i projektit (Strasburg - me 50% kohë): I rekrutuar dhe operativ 	Kompletuar
Ndarja dhe Vendosja e Zyrës së Projektit	Kompletuar
Ngritja e grupit të ekspertëve lokalë dhe ndërkombëtare për aspektet e asistencës teknike LKK dhe LPP/LFT	Iniciuar/Në vazhdim
Prezantimi i projektit për të dy institucionet kryesore përfituese	Kompletuar
Hartimi i planit të punës dhe kalendarit të aktiviteve	Kompletuar
Konfirmimi i anëtarëve të Këshillit Drejtues nga autoritetet e Kosovës	Planifikuar 15 prill 2016
Takimi i parë i Këshillit Drejtues të projektit Miratimi nga palët i planit përfundimtar të punës dhe kalendarit të aktiviteve	Planifikuar 4 maj 2016
Konferenca e lansimit të projektit	Planifikuar 26 maj 2016
Përgatitja dhe dorëzimi i draft raportit fillestar	Paraqitja e planifikuar për 15 prill 2016

6.2 Ngritja e Ekipit të Projektit/Rekrutimi

Secili prej pozicioneve të Ekipit të Projektit në Strasburg dhe Prishtinë është plotësuar në përputhje me politikat dhe procedurat e zbatueshme të burimeve njerëzore të Këshillit të Evropës. Në funksion të kësaj, angazhimi i Këshilltarit të Projektit në Prishtinë dhe Menaxherit të Projektit dhe Asistentit të Projektit në Strasburg u finalizua në janar 2016.

Njoftimet e vende të lira për pozitat e Zyrtarit të lartë të Projektit asistentit gjuhësor u shpallen publikisht në janar 2016 në përputhje me rregullat dhe procedurat e organizatës. Për më tepër, lista e ngushtë e aplikantëve dhe procedurat e mëtejshme të rekrutimit ndodhën gjatë periudhës shkurt-mars 2016. Testet e shkruara online dhe intervistat e kandidatëve të përzgjedhur u organizuan më 15, 17 dhe 18 mars 2016. Deri në fund të marsit 2016, të dy kandidatët e përzgjedhur morën oferta të tyre përkatëse të punësimit. Asistenti gjuhësor i projektit do ta marrë postin e tij më 11 prill 2016, ndërsa Zyrtari i Lartë i projektit do ta marrë pozitën e saj prej 1 majit 2016 në vijim të periudhës aktuale të kërkuar të njoftimit.

Të gjithë aplikuesit dhe pastaj kandidatët janë futur në listën e ngushtë dhe janë përzgjedhur në bazë të kualifikimeve të tyre, përvojës në punë dhe aftësive, si dhe performancës së tyre gjatë testeve online me shkrim dhe intervistave. Përveç kësaj, performanca dhe vlerësimet e punësimit të mëparshëm u konfirmuan me anë të kontrolleve të referencës.

Ekipi i projektit në Prishtinë i raporton direkt Njësisë për Bashkëpunimin kundër Krimin Ekonomik (ECCU) në Departamentin e Veprimin kundër Krimin - DGI për çështjet e lidhura me substancën dhe cilësinë, dhe si i tillë, mbështetet nga Menaxheri i Projektit dhe Asistenti i Projektit në Strasburg. Puna e tyre administrative ditore në Prishtinë do të mbikëqyret dhe mbështetet nga Këshilli i Evropës në Prishtinë.

Në përputhje me nevojat e planit të punës dhe kalendarit të aktiviteteve (Shtojca I) po përpilohet nga ekipi i projektit një listë e përkohshme e ekspertëve ndërkombëtarë dhe kombëtarë për t'u angazhuar në aktivitete të caktuara dhe do të përditësohet në përputhje me rrethanat gjatë gjithë jetëgjatësisë së projektit. TR-të për thirrjen e hapur për ekspertë janë përgatitur dhe do të shpallen jo më vonë se mesi i prillit 2016, ndërsa përdorimi nga projekti i grupit ekzistues të ekspertëve të ECCU-së për çdo aktivitet të menjëhershëm nuk pengohet aspak.

6.3 Zyra/Lokalet e projektit

Zyrat e projektit janë të vendosura brenda ambienteve të vëna në dispozicion të Zyrës së Këshillit të Evropës në Prishtinë e cila gjithashtu siguron infrastrukturën e nevojshme teknike dhe IT për ekipin. Adresa e zyrës së projektit është:

Projekti: PECK II - Kosovë
Zyra e Këshillit të Evropës në Prishtinë
Rruga Bedri Pejani, Nr. 17/18, 10000 Prishtinë, Kosovë
Telefoni: + 381 38 243 749 lok.106; Fax: + 381 38 243 752
Edmond.DUNGA@coe.int

6.4 Aktivitetet e fillimit - (janar - mars 2016)

- **Takime dypalëshe me homologët kryesorë dhe institucione të tjera përfituese**

Në janar 2016, këshilltari i projektit PECK së bashku me menaxherin e ZBEK-së zhvilloi takime dypalëshe me përfaqësuesit e dy institucioneve kryesore përfituese - Agjencisë Kosovare Kundër Korrupsionit (AKK) dhe Njësisë së Inteligjencës Financiare (NJIF).

Diskutimet në këto takime përfshinë: Shpjegimet e roleve përkatëse dhe përfshirjen e institucioneve të interesuara gjatë implementimit të aktiviteteve të projektit; nevojën për të caktuar pikat e kontaktit të qëndrueshme dhe për të identifikuar ekspertë vendorë kur jepet informacioni; dhe çështje të tjera në lidhje me mbështetjen e veprimeve të projektit dhe shpërndarjen e informacionit.

Ndërlidhja dhe takimet e mëtejme me palët e interesit janë planifikuar të zhvillohen më tej përpara organizimit të mbledhjes së Këshillit Drejtues dhe Konferencës së lansimit.

- **Mbështetje dhe asistencë për projektligjin LPP/LFT**

Një rishikim gjithëpërfshirës i Ligjit LPP/LFT dhe hartimi i një ligji të ri ka filluar që në vitin 2014 dhe ka vazhduar në vitin 2015 me përfshirje të ngushtë, asistencë dhe mbështetje nga projekti PECK I në atë kohë. Në shkurt 2016, një draft i rishikuar i Ligjit LPP/LFT u nda nga NJIF-i me ekipin e projektit PECK II për qëllime të konsultimit.

Si rezultat i kësaj dhe që në fillim të marsit 2016, PECK II është tani i angazhuar për të mbështetur finalizimin e këtij procesi duke ofruar ekspertizë dhe këshilla për projektligjin dhe dorëzimin e tij siç është planifikuar për në fund të maj-qershorit 2016.

- **Mbështetje dhe asistencë në fushën e luftimit të financimit të terrorizmit**

Në janar të vitit 2016, Ministria e Punëve të Jashtme organizoi një takim ndërinstitucional me institucionet përkatëse për të diskutuar nevojat për adresimin e mangësive ekzistuese në luftimin e financimit të terrorizmit (KFT), ku u ftua këshilltari i projektit PECK II.

Si pasojë, një Grupi Punues u krijua kohët e fundit prej mesit të muajit mars 2016 nga Ministria e Punëve të Jashtme për hartimin e një koncepti që do të adresojë ndryshimet e nevojshme në ligjin nr. 03/L-183 Ligji për zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare. MD, NJIF dhe PECK II kërkohet të japin kontributin e tyre fillestar për përgatitjen e koncept dokumentit. Për më tepër, projekti PECK II pritet të ofrojë asistencë dhe ekspertizë përcjellëse në fazat e avancuara të këtij procesi.

6.5 Këshilli Drejtues dhe Koordinatorët e Projektit

Sipas Përshkrimit të Veprimit të projektit dhe takimeve të mbajtura me homologët kryesorë, Agjencia Kosovare kundër Korrupsionit (AKK) dhe Njësia e Inteligjencës Financiare (NJIF) do të jenë përgjegjës për koordinimin e aktiviteteve të Projektit në emër të institucioneve të Kosovës dhe për këtë do të caktojë secili nga një Koordinator projekti si ekspert i lartë në çështjet përkatëse lëndore (korrupsioni dhe pastrimi i parave).

Këshilli Drejtues i projektit do të përbëhet nga përfaqësues nga të gjitha institucionet përfutuese/të synuara, Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe Këshilli i Evropës. Ai do të përbëhet nga:

- Zyra për Qeverisje të Mirë pranë zyrës së Kryeministrit;
- Agjencia Kosovare kundër Korrupsionit;
- Njësia e Inteligjencës Financiare;
- Ministria e Drejtësisë;
- Ministria e Financave;
- Ministria e Punëve të Brendshme;
- Policia e Kosovës;
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës;
- Këshilli Prokurorial i Kosovës;
- Prokuroria Speciale e Kosovës;

- Banka Qendrore e Kosovës;
- Ministria e Integritetit Evropian;
- Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë; dhe
- Njësia për Bashkëpunimin kundër Krimin Ekonomik e Këshillit të Evropës / zyra e Këshillit të Evropës në Prishtinë.

Derisa përfaqësuesit e këtyre institucioneve do të duhet të jenë anëtarë të përhershëm të Këshillit Drejtues të këtij projekti, është kërkuar një emërimi zyrtar i secilit anëtar të përhershëm nga homologët kryesorë siç tregohet më lart dhe pritet që emërimet e tilla të bëhen jo më vonë se data e ngjarjes së fillimit.

Koordinatorët kyç të projektit do të jenë nga: Agjencia kundër Korrupsionit e Kosovës, që do të jetë koordinatori qendror për komponentin e luftës kundër korrupsionit, dhe Njësia e Inteligjencës Financiare që do të jetë koordinator për komponentin kundër pastrimit të parave.

Takimet e Këshillit Drejtues do të përfshijnë autoritetet e tjera relevante që lidhen me rezultatet e projektit dhe aktivitetet sipas nevojës. Përbërja përfundimtare e Këshillit Drejtues do të diskutohet në fazën fillestare dhe do të miratohet nga Konferenca fillestare. Këshilli Drejtues do të marrë vendime strategjike dhe do të mbikëqyrë zbatimin e duhur të projektit. Takimet e Këshillit Drejtues do të zhvillohen të paktën çdo 6 muaj, dhe në baza të posaçme sa herë që lind nevoja e tillë. Termet e referencës së Këshillit Drejtues janë bashkangjitur në këtë raport dhe do të miratohen në takimin e parë të Këshillit drejtues. Kryesimi i KD-së do të vendoset gjatë fazës fillestare, duke marrë në konsideratë përvojën e mëparshme evoluese të PECK I, ku përfituesit kryesonin mbledhjet e KD-së dhe pas një kohe u bashkë-kryesuan nga donatori dhe agjencia zbatuese - duke lëvizur përpara dhe demonstruar më shumë pronësi.

Institucione të tjera përfituese përfshijnë Ministrinë e Drejtësisë (hartimi legjislativ dhe inspektimet), Ministrinë e Financave (si institucioni nga varet NJIF-i), Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Policinë së Kosovës (hetimet e krimin ekonomik), Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Këshillin Prokurorial, Zyrën e Prokurorit Special, Agjencinë për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara (AAPSK), si edhe Bankën Qendrore të Kosovës. Në lidhje me RP 3 dhe RP 4 (procesi i vlerësimit), Këshilli i Evropës do të caktojë 3 ekspertë ndërkombëtarë si shqyrtues kolegjalë për secilin komponent. Ekspertët në çdo ekip do të marrin pjesë në vlerësimin e Projektit duke pasur parasysh rolin e secilit në hartimin e politikave, reformave legjislative si dhe komponentët e ndërtimit të kapaciteteve.

Homologët institucionalë do të jenë të përfshirë në mënyrë aktive në të gjithë hapat e zbatimit të projektit.

Institucionet e tjera dhe strukturat dhe agjencitë e zbatimit të ligjit, sektori financiar dhe industria, si dhe shoqëria civile do të jenë të përfshirë në aktivitetet e ndryshme specifike të projektit. Përfituesit përfundimtarë përfshijnë shoqërinë në përgjithësi në atë masë që ajo përfiton nga një kornizë efektive kundër korrupsionit dhe kundër pastrimit të parave/kundër financimit të terrorizmit dhe ndikimi i saj i pritur afatgjatë.

Mbledhja fillestare e Këshillit Drejtues të projektit është planifikuar paraprakisht të mbahet më 4 maj 2016.

6.6 Lansimi i projektit

Do të mbahet një seri e takimeve përgatitore me aktorët kryesorë të projektit në dritën e Konferencës së lansimit të Projektit PECK II, veçanërisht AKK, NJIF dhe Zyra e BE-së në Prishtinë për të diskutuar formatin e Konferencës, si dhe hapat e mëtejshëm dhe aktivitetet e projektit.

Projekti kundër Krimin Ekonomik në Kosovë (PECK II) do të lansohet zyrtarisht në Konferencën e lansimit në Prishtinë, e planifikuar të mbahet në maj 2016 (shih shtojcën VI - Draft Agjenda e konferencës së lansimit). Në Konferencën e Lansimit pritet të marrin pjesë rreth 100 përfaqësues të ministrive përkatëse dhe agjencive, organizatave ndërkombëtare, sektorit privat dhe shoqërisë civile. Prania e autoriteteve të nivelit të lartë, si dhe pjesëmarrja e një game të gjerë të ministrive dhe agjencive në Konferencën e Lansimit është një faktor kyç për të siguruar angazhimin e nevojshëm afatgjatë për realizimin e aktiviteteve të projektit dhe rezultateve të tij.

7 VIZIBILITETI/MBULIMI MEDIATIK

7.1 Faqja e internetit e KiE dhe PECK II

Lajmet e projektit, ngjarjet në vijim, dhe rezultatet/të arritshmet do të raportohen rregullisht në faqen e Krimin Ekonomik të Këshillit të Evropës (www.coe.int/corruption), në seksionin e dedikuar ekskluzivisht për projektin PECK: www.coe.int/peck2

Faqja e internetit do të raportojë rregullisht mbi të gjitha aktivitetet e projektit dhe rezultatet, si dhe lajme. Kjo faqe zyrtare e projektit të Këshillit të Evropës do të ketë lidhje me faqet e tjera relevante në Kosovë dhe jashtë vendit.

Aktivitetet e rëndësishme të projektit, lajmet dhe ngjarjet e ardhshme në Projektin PECK II do të paraqiten edhe në faqen e internetit të Zyrës së Këshillit të Evropës në Prishtinë (www.coe.int/pristina).

7.2 Dukshmëria e BE-së

Projekti do të sigurojë dukshmërinë e kontributit të BE-së në të gjitha fazat e aktiviteteve. Këshilli i Evropës do të marrë të gjitha masat e duhura për të publikuar faktin se financimi i projektit merret nga një marrëveshje e Bashkimit Evropian. Çdo raportim dhe informim i përdorur dhe shpërndarë do të pohojë se veprimet kryhen "me financim nga Bashkimi Evropian", duke shfaqur edhe logon e Bashkimit Evropian në mënyrën e duhur. Projekti do të zbatojë Planin e komunikimit dhe dukshmërisë (Shtojca VI e kontratës BE/KiE). Një Plan i detajuar Komunikimi dhe Dukshmërie është përfshirë në shtojcën VII të këtij raporti.

7.3 Përgjegjësia nga përgjegjësia

Të gjitha publikimet do të përfshijë përgjegjësinë e mëposhtme: "Ky dokument është realizuar me ndihmën financiare të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës. Pikëpamjet e shprehura këtu nuk mund të pasqyrojnë në asnjë mënyrë mendimin zyrtar të Bashkimit Evropian ose të Këshillit të Evropës."

7.4 Publikime

Projekti do të prodhojë raporte për të përditësuar dhe informuar Zyrën e Bashkimit Evropian në Prishtinë mbi gjetjet dhe progresin e zbatimit të projektit. Gjatë projektit do të përdoren libërtha, broshura, fletëpalosje, dhe kopjet e tillë do të jenë në dispozicion për raportimin. Siç është përcaktuar në Kushtet e Përgjithshme të Marrëveshjes së projektit, "Çdo [produkti i projektit] publikim dhe njoftim për shtyp do t'i komunikohet Autoritetit Kontraktues [Zyra e Bashkimit Evropian në Prishtinë] ashtu siç lëshohen". Nëse ndodh ndonjë botim, do të pranohet kontributin financiar të BE-së, dhe do të përmbajë mohimin e lartpërmendur. Ato gjithashtu do të jenë në dispozicion për publikun.

8 BUXHETI DHE KONTRIBUTET

Kostoja totale e projektit për periudhën 36 mujore përfshin një total prej 2.225.000 €. Kjo shumë përfshin:

2.000.000 EUR kontributi financiar nga BE-ja (89,89%); dhe
225.000 EUR kontributi financiar nga KiE (10,11%).

Pas nënshkrimit të kontratës (22 dhjetor 2015), dhe pas dorëzimit të Kërkesës së 1^{re} për Pagesë, Këshilli i Evropës ka marrë një shumë fillestare prej **671.541,00 Euro**, si kësti i para-financimit në përputhje me nenin 4(2) të Kushteve të veçanta.

9 HAPAT E ARDHSHËM DHE KONKLuzionET

9.1 Hapat e Ardhshëm

Propozimi i projektit është përkthyer në një plan pune të detajuar dhe me kalendar kohor. Plani i punës ka për qëllim të shfrytëzojë ekspertizën kombëtare dhe ndërkombëtare për të siguruar ekspertizë dhe asistencë të shënjestruar.

Draft i **planit të punës së aktiviteteve** së bashku me këtë **raport fillestar** janë përgatitur gjatë periudhës fillestare dhe do të shqyrtohen dhe diskutohen në takimin e 1^{re} të Këshillit Drejtues të planifikuar paraprakisht për 28 prill 2016, pas konsultimeve të brendshme mes KiE dhe Zyrës së BE-së në Prishtinë.

9.2 Ndikimi më afatgjatë

Projekti do të asistojë autoritetet e Kosovës në zbatimin e rekomandimeve të caktuara nga ciklet e mëparshme të vlerësimit të kryera në kuadër të PECK I, nëpërmjet asistencës teknike të shënjestruar, si dhe duke vazhduar me vlerësimin e strukturuar të kornizave LPP/LFT në raport me standardet ndërkombëtare në zhvillim e sipër. Aktivitetet e asistencës teknike do të mbulojnë dy komponentë (korrupsionin dhe pastrimin e parave) duke trajtuar aspekte të ndërtimit të kapaciteteve të lidhura me krimin ekonomik në raport me reformat legjislative, institucionale, politike dhe operacionale. Ato do të mbështesin më tej autoritetet e Kosovës që të marrin pjesë më mirë në procesin e ardhshëm të vlerësimit që do të kryhet gjatë vitit të fundit të PECK II (2018).

Projekti pranon nevojën që Kosova të vazhdojë të ketë një proces gjithëpërfshirës dhe të strukturuar të vlerësimit. Në bazë të përvojës së suksesshme të herës së parë, komponentët e dizajnuar specifikisht të projektit do të kenë si qëllim, strategji dhe burime ndërmarrjen e vlerësimeve periodike dhe të plota në Kosovë mbi çështjet e krimit ekonomik dhe më specifikisht: korrupsionit; pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Vlerësimi do të mbulojë fushat institucionale, të politikave dhe burimeve fushat të ndara në tema të veçanta kryesisht modeluar sipas mekanizmave në zhvillim e sipër të Këshillit të Evropës (GRECO dhe MONEYVAL) dhe metodologjive të tyre, si dhe të përshtatura për kontekstin e Kosovës.

10 LISTA E SHTOJCAVE

- Shtojca I: Plani i punës dhe Kalendari i aktiviteteve
- Shtojca II: Lista e institucioneve përfituese
- Shtojca III: Termat e referencës të Këshillit Drejtues të Projektit
- Shtojca IV: Agjenda e takimit të parë të Këshillit Drejtues të projektit, 4 maj 2016
- Shtojca V: Agjenda e Konferencës së Nisjes së Projektit PECK II, 26 maj 2016
- Shtojca VI: Faqja e internetit e projektit PECK II
- Shtojca VII: Plani i Komunikimit dhe Vizibilitetit i PECK II
- Shtojca VIII: Ekipi i Menaxhimit të Projektit PECK II

Shtojca II:

Institucionet përfituese nga projekti PECK II si dhe rolet e tyre¹

Përfituesi	Roli	Fusha
Agjencia kundër Korrupsionit (AKK)	Përfitues kryesordirekt dhe kordinator lokal për AK, anëtar i Këshillit Drejtues (KD)	LKK
Njësia e Inteligjencës Financiare (NJIF)	Përfitues kryesor direkt dhe kordinator lokal për LPP/LFT Anëtar i Këshillit Drejtues (KD)	LPP/LFT
Zyra për Qeverisje të Mirë, Drejtat e Njeriut, Çështjet e Mundësive të Barabarta dhe Gjinisë/Zyra e Kryeministrit (ZKM)	Anëtar i KD	LKK – LPP/LFT
Ministria e Drejtësisë (MD)	Anëtar i KD	LKK – LPP/LFT
Ministria e Financave (MF)	Anëtar i KD	LKK – LPP/LFT
Ministria e Punëve të Brendshme (MPB)	Anëtar i KD	LKK – LPP/LFT
Policia e Kosovës (PK)	Anëtar i KD	LKK – LPP/LFT
Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGjK)	Anëtar i KD	LKK – LPP/LFT
Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK)	Anëtar i KD	LKK – LPP/LFT
Prokuroria Speciale të Kosovës (ZPSK)	Anëtar i KD	LKK – LPP/LFT
Banka Qëndrore e Kosovës (BQK)	Anëtar i KD	LPP/LFT
Ministra e Integriteteve Evropian (MIE)	Anëtar i KD	LKK – LPP/LFT
Zyra e Prokurorit të Shtetit (ZPSH)	Përfitues sektorial	LKK – LPP/LFT
Kordinatori Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik (KKLK)	Përfitues sektorial	LKK – LPP/LFT
Doganat e Kosovës (DK)	Përfitues sektorial	LKK – LPP/LFT
Administrata Tatimore e Kosovës (ATK)	Përfitues sektorial	LKK – LPP/LFT
Inspektorati Policor i Kosovës (IPK)	Përfitues sektorial	LKK – LPP/LFT
Akademia e Kosovës për Siguri Publike (AKSP)	Përfitues sektorial	LKK – LPP/LFT
Gjykata Supreme (GjK)	Përfitues sektorial	LKK – LPP/LFT
Gjykata Kushtetuese	Përfitues sektorial	LKK – LPP/LFT
Instituti Gjyqësor i Kosovës (IGjK)	Përfitues sektorial	LKK – LPP/LFT
Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar (AAPSK)	Përfitues sektorial	LKK – LPP/LFT
Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve e Kosovës (ARBK)	Përfitues sektorial	LKK – LPP/LFT
Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve (KQZ) (përfshirë zyren për regjistrimin dhe çertifikimin e partive politike)	Përfitues sektorial	LKK
Kuvendi i Kosovës (KK)	Përfitues sektorial	LKK
Ministry e Administrates Publike (MAP)	Përfitues sektorial	LKK
Instituti i Administrates Publike (IAP)	Përfitues sektorial	LKK
Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës	Përfitues sektorial	LKK
Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP)	Përfitues sektorial	LKK
Ombudspersoni i Kosovës (KO)	Përfitues sektorial	LKK
Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRrPP)	Përfitues sektorial	LKK

¹ This is not an exhaustive list which would be adjusted during implementation depending on actual and coordinated needs.

Përfituesi	Roli	Fusha
Organi Shqyrtues i Prokurimit (OShP)	Përfitues sektorial	LKK
Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP)	Përfitues sektorial	LKK
Agjencia e Kosovës për Inteligjencë (AKI)	Përfitues sektorial	LPP/LFT
Departament për Regjistrim dhe Ndërlidhjen e OJQ-ve (DRNOJQ)	Përfitues sektorial	LPP/LFT
Industria e sektorit financiar (bankat, institucionet mikro-financiare, shërbimet e transferit të parave ose të valutave, zyret e shkëmbimit)	Përfitues sektorial	LPP/LFT
OJP-të	Përfitues sektorial	LPP/LFT
Profesionet dhe Bizneset e Caktuara Jo-financiare: avokatët, noterët, auditorët, kontabilistët, kazinot, agjentët e patundshmërisë, tregtarët e metaleve dhe gurëve të çmuara si dhe shërbimet e ndryshme ndaj kompanive	Përfitues sektorial	LPP/LFT
Shoqatat profesionale: Shoqata e Bankierëve të Kosovës, Shoqata e Institucioneve Mikrofinanciare të Kosovë (SHIMK), Avokatët, Dhoma e Noterëve, Shoqëria e Kontabilistëve dhe Auditorëve të Çertifikuar të Kosovës (SKAÇK) etj...	Përfitues sektorial	LPP/LFT

SHTOJCA III



Projekti kundër Krimin Ekonomik në Kosovë¹ (PECK II)

Termet e References së Këshillit Drejtues (KD)

1. Antarësia në KD/Pjesëmarrja

Këshilli Drejtues i këtij projekti do të përbëhet nga përfaqësuesit e mëposhtëm:

- Zyra për Qeverisje të Mirë pranë Zyrës së Kryeministrit
- Agjencia e Kosovës kundër Korrupsionit;
- Njësia e Inteligjencës Financiare;
- Ministria e Drejtësisë;
- Ministria e Financave;
- Ministria e Punëve të Brendshme
- Policia e Kosovës
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës
- Këshilli Prokurorial i Kosovës
- Zyra e Prokurorit Special të Kosovës
- Banka Qendrore e Kosovës
- Ministria e Integritit Evropian
- Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë
- Njësia e Krimin Ekonomik dhe e Bashkëpunimit e Këshillit të Evropës

Këshilli Drejtues do të përfshijë gjithashtu në takimet e tij autoritete të tjera përkatëse të lidhura me rezultatet dhe veprimtaritë e projektit. Këshilli Drejtues do të kryesohet bashkërisht nga një përfaqësues i ZBE-së dhe një i KE-së. Përgjegjësitë e Sekretarisë të KDP-së do të merren nga ekipi i projektit.

2. Përgjegjësitë e KD

Këshilli Drejtues do të marrë vendime strategjike dhe do të mbikëqyrë zbatimin e duhur të Projektit. Ai do të trajtojë çështjet kryesore me të cilat mund të përballet projekti. Këshilli Drejtues do të ftohet në takim të paktën 6 herë gjatë zbatimit të projektit dhe kurdoherë që paraqitet nevoja për takim. Përgjegjësitë e Këshillit Drejtues janë si më poshtë:

- Monitorimi i zbatimit të projektit dhe diskutimi i arritjeve të tij;
- Miratimi i planeve të punës dhe raporteve të progresit, përfshirë atë fillestar dhe atë përfundimtar;
- Vlerësimi i çështjeve të reja që shfaqen për zbatimin e duhur të projektit dhe miratimi i udhëzimeve që dalin për Menaxhimin e Projektit;

¹ Ky shënim është pa paragjykim të qëndrimeve mbi statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 të KS të OKB-së dhe Opinionin e GJND-së për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës

- Miratimi i shmangieve të domosdoshme nga Termat fillestare të Referencës ose Plani i Punës;

3. Takimet e KD dhe kalendari

Këshilli Drejtues do të ftohet në takim në fillim të projektit dhe të paktën një herë në gjashtë muaj dhe kurdoherë që të shfaqet nevoja. Në vazhdim është Kalendari i përafërt i Takimeve të Rregullta të KD:

Numri i takimeve të rregullta të KD	Takimi i parë	Takimi i dytë	Takimi i tretë	Takimi i katërt	Takimi i pestë	Takimi i gjashtë
Datat e planifikuara	Maj 2016	Tetor 2016	Prill 2017	Tetor 2017	Prill 2018	Tetor 2018

4. Lista e anëtarëve të përhershëm të caktuar për KD nga institucionet e Kosovës

Name	Institution/Position	I emëruari kryesor	Zëvendësuesi	Adresa/telefoni/email
Habit Hajredini	Drejtor, Zyra për Qeverisje të Mirë pranë Zyrës së Kryeministrit	+		habit.hajredini@rks-gov.net
Trendeline Dreshaj	Zyra për Qeverisje të Mirë pranë Zyrës së Kryeministrit		+	trendeline.dreshaj@rks-gov.net
Hasan Preteni	Drejtor, Agjencia e Kosovës kundër Korrupsionit	+		hasan.preteni@rks-gov.net
Blerim Kelmendi	Agjencia kundër Korrupsionit, Drejtoria e hetimeve		+	blerim.kelmendi@rks-gov.net
Dardan Nuhiu	Drejtor, Njësia e Inteligjencës Financiare	+		dardan.nuhiu@fic-ks.org
Flutra Blakçori	Zyrtare ligjore, Njësia e Inteligjencës Financiare		+	flutra.blakçori@fic-ks.org
Lulzim Beqiri	Drejtor, Departamenti për Integritet Evropian dhe Kordinim të Politikave, Ministria e Drejtësisë	+		Lulzim.Beqiri@rks-gov.net
Selviqe Elezaj	Drejtoreshë, Divizioni për Kordinim të Politikave, Ministria e Drejtësisë		+	Selviqe.Elezaj@rks-gov.net
Berat Havolli	Analist i Lartë i Makroekonomisë, Ministria e Financave	+		Berat.Havolli@rks-gov.net

Armend Shabani	Zyrtar i lartë për Integritet Evropian, Ministria e Punëve të Brendshme	+		Armend.Shabani@rks-gov.net
Shaip Havolli	Drejtor i Sektorit të Hetimeve të Krimit Ekonomik, Policia e Kosovës	+		Shaip.Havolli@KosovoPolice.com
Astrit Hoti	Drejtor, Departamenti Ligjor, Këshilli Gjyqësor i Kosovës	+		Astrit.Hoti@rks-gov.net
Aferdita Bytyqi	Gjykatëse, Gjykata Themelore e Prishtinës, Departamenti i Krimeve të Rënda	+		Aferdita.Bytyqi@rks-gov.net
	Kosovo Prosecutorial Council			
Faton Mecinaj	Administrator, Zyra e Prokurorit Special	+		Faton.Mecinaj@rks-gov.net
Migjen Selmani	Ekspertt, Zyra e Prokurorit Special	+		Migjen.Selmani@rks-gov.net
Labinot Preniqi	Udhëheqës i Divizionit për Parandalimin e Shpërlarjes së Parasë, Banka Qëndrore e Kosoves	+		Labinot.Preniqi@bqk-kos.org
Atif Hoxha	Zyrtar i Pajtueshmërisë, Banka Qëndrore e Kosoves		+	Atif.Hoxha@bqk-kos.org
Krenare Bektashi	Zyrtare e Lartë, Ministria e Integritet Evropian	+		Krenare.Bektashi@rks-gov.net



Projekti kundër Krimit Ekonomik në Kosovë* (PECK II)

www.coe.int/peck2

Agjenda

Konferenca e Lansimit të Projektit

Prishtinë, 26 May 2016

Vendi: Ndërtesa e Qeverisë (Salla P038)

08:45 – 09:15	Regjistrimi
09:15 – 10:00	Fjalimet hyrëse <ul style="list-style-type: none">- Z. Isa MUSTAFA, Kryeministër i Kosovës- Z. Hajredin KUÇI, Ministër i Drejtësisë- Z. Samuel ŽBOGAR, Udhëheqës i Zyrës së BE-së në Kosovë /Përfaqësues Special i BE-së- Z. Ivan KOEDJIKOV, Udhëheqës i Departamentit të Veprimit Kundër Krimit, Këshilli i Evropës
	<i>Moderatore: Znj. Edis AGANI, Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë</i>
10:00 – 10:30	<i>Pauzë për kafe</i>
10:30 – 11:15	Luftimi kundër korrupsionit dhe pastrimit së parave e financimit të terrorizmit në Kosovë Folës kryesorë: <ul style="list-style-type: none">- Znj. Sevdije MORINA, Zëvendës Kryeprokurore e Shtetit- Z. Hasan PRETENI, Udhëheqës i Agjencisë kundër Korrupsionit të Kosovës- Z. Dardan NUHIU, Udhëheqës i Njësisë së Inteligjencës Financiare të Kosovës
	<i>Moderator: Z. Ivan KOEDJIKOV, Udhëheqës i Departamentit të Veprimit Kundër Krimit, Këshilli i Evropës</i>
11:15 – 11:45	Prezantim i Projektit, rezultateve të pritura dhe aktiviteteve <ul style="list-style-type: none">- Z. Edmond DUNGA, Këshilltar i Projektit PECK II
11:45 – 13:00	Diskutime / Pyetje për aktivitetet dhe veprimet madhore të planifikuara dhe të miratuara nga Këshilli Drejtues i Projektit
13:00 – 14:00	<i>Pritja</i>

* Ky shënim është pa paragjykim të qëndrimeve mbi statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 të KS të OKB-së dhe Opininionin e GJND-së për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.

SHTOJCA III

PLANI I KOMUNIKIMIT DHE I VIZIBILITETIT

A. Objektivat

1. Objektivat e përgjithshme të komunikimit

Plani i komunikimit të projektit ka për qëllim që të siguroj që mbështetja dhe asistenca e BE/KE tek autoritetet kosovare për t'i luftuar dhe parandaluar në mënyrë efikase korrupsionin, pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit brenda kornizës së projektit të përbashkët BE/KE kundër Krimit Ekonomik në Kosovë (PECK II) të jetë i dukshëm dhe i njohshëm nga autoritetet e Kosovës, profesionalët dhe publiku i përgjithshëm. Do të siguroj dukshmërinë e objektivave, veprimeve, rezultateve dhe detyrave të projektit.

Iniciativat e komunikimit do të përqipen që t'i përfshijnë në mënyrë aktive institucionet përfituese dhe publikun e përgjithshëm për ta rritur angazhimin e tyre.

2. Grupet e synuara

Në Kosovë:

- Publiku i përgjithshëm
- Ministritë relevante (mbulimi i drejtësisë, punëve të brendshme, fushave të financave dhe administrates publike), institucionet e zbatimit të ligjit, strukturat specifike qeveritare dhe institucionet qendrore, agjencitë ekzekutive kyçe;
- Sektori financiar, industria dhe shoqëria civile

3. Objektivat specifike për secilin grup të synuar

Synimi i aktiviteteve të komunikimit/vizibilitetit të cekura më lartë është:

- Ta vetëdijësoj publikun e përgjithshëm rreth ekzistencës së projektit, objektivave dhe detyrave si dhe rolet dhe vlerat e Këshillit të Evropës dhe të BE-së në luftimin dhe parandalimin e efektshëm të korrupsionit dhe krimit ekonomik;
- T'i familiarizojë ekspertët anti-korrupsion dhe kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit si dhe palët e projektit përmes përfshirjes direkte në aktivitetet e projektit dhe/ose përmes detyrave të projektit të standardeve Evropiane dhe procedurave në fushën e krimit ekonomik, si dhe rekomandimeve specifike për Kosovën;
- Të rritet vetëdijësimi publik i faktorëve që çojnë te rreziqet dhe pasojat e korrupsionit dhe krimit ekonomik, rritje dialogut dhe ndërtim i besimit publik në institucionet shtetërore;
- Ta përfshijë në mënyrë më aktive shoqërinë civile dhe publikun e përgjithshëm në luftën kundër korrupsionit dhe pastrimit të parave/financimit të terrorizmit.

B. Aktivitetet e komunikimit

4. Aktivitetet kryesore që do të ndodhin gjatë periudhës së mbuluar nga plani i komunikimit dhe vizibilitetit

Implementimi i projektit përfshinë rishikim legjislativ, vlerësime të nevojave dhe të rrezikut, seminare të trajnimeve, punëtori, vizita studimore, konferenca rajonale dhe vlerësime të stilit GRECO dhe Moneyval mbi përshtatshmërinë e Kosovës me standardet ndërkombëtare anti-

korrupsion/anti-pastrim parash dhe financim të terrorizmit.

Përgjegjësia për këto aktivitete bie tek ekipi i zbatimit të projektit si dhe të palët në Kosovë.

5. Mjetët e komunikimit

N.B. Lista e mëposhtme e mjeteve të komunikimit dhe vizibilitetit nuk është finale. Do të zhvillohet më tej dhe diskutohet me palët kryesore të projektit gjatë fazës fillestare dhe aprovohet nga Komiteti Drejtues/Konferenca Lansuese.

Duke pasur parasysh natyrën e projektit, mjetet me të përshtatshme komunikimi konsiderohet të jenë:

- Mjete mediatike:
 - Njoftimet e rregullta për shtyp në lidhje me aktivitetet e projektit;
 - Ngjarjet hapëse dhe mbyllëse të mediatizuara të projektit
 - Ngjarje të vizibilitetit për t'i prezantuar arritjet kryesore të projektit (vlerësime të rrezikut, raporte të vlerësimit mbi LKK dhe LPP/LFT, studime, manuale/udhëzime etj....).

- Mjetet e vizibilitetit:
 - Një banderolë që shfaqet në të gjitha ngjarjet e projektit;
 - Gjëra promocionale/për vizibilitet (fletore për shënime, stilolapsa, dosje, çanta për konferenca, USB etj me logo të projektit) që shpërndahen gjatë seciles ngjarje;
 - Broshura/fletëpaloshje që përshkruan objektivat e projektit dhe rezultatet e pritura të prodhuara dhe që shpërndahen sa më shumë;
 - Publikimet e projektit (raporte vlerësimi, analiza të rrezikut, manuale të trajnimit, udhëzime etj.)

- Mjetet e komunikimit:
 - Një faqe e internetit, e cila azhurnohet rregullisht me lajme mbi aktivitetet e projektit, arritjet kryesore dhe dokumentet e krijuara;
 - Kampanja vetëdijësimi rreth faktorët që çojnë te rreziqet dhe pasojat e korrupsionit dhe krimit ekonomik, rritja e dialogut dhe ndërtimi i besimit të institucionet shtetërore

6. Plotësimi i objektivave të komunikimit

Raporti i vlerësimit të projektit do ta vlerësoj zbatimin e objektivave të komunikimit përmes:

- Një vlerësim medial të pesë publikimeve kyçe që mbulojnë aktivitetet e projektit;
- Vështrim i komenteve të pjesëmarrësve në aktivitete të projektit.

7. Dispozitat për komente

Shumica e aktiviteteve të projektit do të përfshijnë forma të vlerësimit për pjesëmarrësit. Do të përfshijnë, ndër tjerash, pyetjen në lidhje me vizibilitet.

8. Burimet njerëzore

- Një profesionist i komunikimit do të identifikohet dhe përzgjedhet përmes procedurës së tenderit për të zhvilluar strategji të vizibilitetit dhe të komunikimit në konsultim dhe bashkëpunim të ngushtë me ekipin e projektit dhe partnerët e projektit, që do të përfshijë, ndër tjerash, dizajnimin e materialeve të vizibilitetit/promovimit dhe kampanjat e vizibilitetit/vetëdijësimit;
- Ekipet e projektit në Prishtinë dhe Strasbourg do të jenë përgjegjëse për: i) mirëmbajtje dhe mbajtje e faqes së internetit të azhurnuar në mënyrë të rregullt me lajme mbi aktivitetet e, arritjet dhe rezultatet e projektit; ii) përgatitja dhe shpërndarja e fletëpalosjeve/broshurave dhe materialeve promociionale si dhe publikimeve të projektit

9. Burimet financiare

70,000 EUR janë paraparë për aktivitetet e komunikimit dhe vizibilitetit, që përbëjnë 3.15% të buxhetit total.

Kontakti në Seli (Strasbourg)

Njësia e Krimit Ekonomik dhe Bashkëpunimit (ECCU)

Departamenti i Veprimit kundër Krimit
Drejtoria e Shoqërisë së Informacionit dhe Veprimit kundër Krimit
DG I – Drejtoria e Përgjithshme e Drejtave të Njeriut dhe Zbatimit të Ligjit
Këshilli i Evropës
F-67075 Strasbourg Cedex
Tel: +33 (0)3 88 41 26 29
Fax: +33 (0)3 88 41 27 05

Menaxhere e Projektit

Znj Maia MAMULASHVILI
Tel: +33 (0)3 90 21 42 14
Fax: +33 (0)3 88 41 27 05
Email: Maia.MAMULASHVILI@coe.int

Ekipi i Projektit në Prishtinë/Kosovë*

Këshilltar i Projektit

Z. Edmond DUNGA
Tel: +381 (38) 243 749 ext. 106
Fax: +381 (38) 243 752
Email: Edmond.DUNGA@coe.int

Zyrtare e Lartë Projektit

Znj Vlora MARMULLAKAJ
Tel: +381 (38) 243 749 ext. 105
Fax: +381 (38) 243 752
Email: Vlora.MARMULLAKAJ@coe.int

Asistent Gjuhësor i Projektit

Z. Shpend MIFTARI
Tel: +381 (38) 243 749 ext. 110
Fax: +381 (38) 243 752
Email: Shpend.MIFTARI@coe.int

Këshilli i Evropës – Zyra në Prishtinë

Rruga Bedri Pejani , nr.3
10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (38) 243 749 or 750
Fax: +381 (38) 243 752
Email: coe.pristina@coe.int